



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 15 MARS 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 15. MARTA 2012. GODINE**

**MARS – MART
2012**

E enjte, më 15. 03. 2012

Drejton seancën nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Të nderuar deputetë dhe deputete,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Po hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare.

Prezentë në sallë janë 70 deputetë.

Po fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës e që është

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Siç e dini, koha për diskutime jashtë rendit të ditës, është e kufizuar në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat 5 minuta dhe ju lus që të paraqiteni me kohë kush është në emër të Grupit Parlamentar, ndërsa diskutimi i deputetit zgjat deri në 3 minuta. Ju faleminderit!

Sipas radhës, a është dikush në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, që janë paraqitur disa. Jo.

Atëherë, personalisht fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë dhe të nderuara deputete,

Pika e parë e rendit të ditës sipas Rregullores së Kuvendit, është për të ngritur shqetësime të qytetarëve. Por, kjo pikë, në shumtën e herëve, është duke u keqpërdorur dhe ka filluar të krijojë shqetësime te qytetarët, duke

filluar nga prishja e imazhit për të zgjedhurit e tyre e deri te shqetësimi për të tashmen e për të ardhmen e këtij vendi. Dhe, pikërisht në kohën kur kërkohet një sjellje më e përgjegjshme prej çdo qytetari deri te përfaqësuesit e tyre dhe, sidomos një shkallë shumë më e lartë të përfaqësuesve të tyre, mundësisht, aq sa i ka karakterizuar njerëzit e këtij vendi këtu e më shumë se 100 vjet. Atëherë, kur shumë njerëz kishin mërsyer vendet e shkollimit në qendrat e Romës, Selanikut dhe të Stambollit dhe pse atje merrnin edhe formim teologjik dhe konsolidonin dijet e tyre për besimet fetare të cilave u përkisnin që para se të shkonin atje. Pavarësisht, nëse ishin të përgatitur, po përgatiteshin për priftërinj katolikë, për peshkopë ortodoks apo për imamë islam, ende pa u kthye në vendlindje, duke parë rreziqet e vendit të tyre dhe duke parë copëtimin e popullit të tyre, ata që të gjithë formuan një emancipim e një ndërgjegje dhe erdhën në një përfundim të përbashkët që u bë program kombëtar dhe u bë formula më magjike shpëtimtare. Krijuan definicionin më sintetizues të divirsiteve që është unikat dhe i papërsëritshëm, prej themelimit të besimeve deri sot, te asnjë etni tjetër më shumë besime sikur ky që është populli ynë.

Tani pas 100 vitesh në këtë kohë kur kemi vetëm 4 vjet që kemi shpallur pavarësinë e Kosovës, ku kemi një brishtësi të institucioneve tona në konsolidim, një përkushtim permanent dhe devotshëm, kur kemi një bjeshkë me plagë të luftës së fundit aq të ashpra aq çnjerëzore, kur kemi një kurorë bjeshkësh me nevojë imediate sociale - politike të krijuara nga ajo kohë e deri tani, kur kemi një stizë sfidash kërcënuese nga politika hegjemone dëshpëruese e Beogradit zyrtar, aktualisht, kur kemi një përkrahje të pashembullt në historinë tonë nga faktorët vendimmarrës për fatin e këtij globi. Në këto rrethana nuk do të duhej të mungojë një unitet i të gjitha forcave politike parlamentare dhe jo parlamentare, madje edhe i shoqërisë civile, sepse jemi të rrethuar me një kompleks faktorësh që bashkëveprojnë dhe funksionojnë në varësi prej njëri - tjetrit dhe shumë paraqitje subjektive me konotacione etiketuese, njollosëse, ofenduese, duke motivuar me diskurse pseudo-politike rrënuese, të cilat nuk trajtojnë shqetësime reale siç është në Rregullore, kështu vetvetiu krijojmë shqetësime të reja dhe precedentë, shumë të padenja për publikun.

Veçanërisht që në fillim të mbledhjeve po krijojmë në ambient të rëndë dhe një raport konfrontues në mes të subjekteve politike, duke krijuar ambient të rëndë pune këtu dhe duke paraqitur një shije, për qua një shije të hidhur, i cili përcillet me vëmendje punimet e këtij Kuvendi.

Mendoj se është koha të reflektojmë të gjithë qytetarët dhe sidomos të zgjedhur të tyre që të kultivojmë një gjuhë dhe një sjellje të dinjitetshme...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, a është dikush apo si deputetë të gjithë janë paraqitur, si deputetë.

Atëherë, a ka dikush në emër të Grupit?

Fjalën e ka deputetja Bytyçi. S'po paraqiteni në emër të grupit parlamentar, atëherë sipas radhës.

KIMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

E mora fjalën për të shprehur shqetësimin tim pas shumë takimeve që kam pasur me qytetarët e komunave të Istogut dhe të Pejës, të cilët më herët kanë pësuar dëme të shkaktuara nga erërat të cilat këto ditë tronditën dhe një herë Istogun duke i shkaktuar dëme.

Në mbledhjen e saj të mbajtur më 11.1.2012, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndarë vetëm 400 mijë euro për tri komuna: Istog, Pejë dhe Klinë.

Për të mbuluar dëmet e shkaktuara nga erërat e forta që këto ditë këto komuna përjetuan më herët, dëmet e vlerësuara vetëm në komunën e Istogut kapin vlerën prej rreth 5.2 milionë euro, atë të Pejës mbi një milion, pa përfshirë këtu dëmet në rrjetin energjetik, që

la këto komuna disa ditë në terr të plotë, sot e kësaj dite plot familje që janë pa kulm mbi kokë.

Qytetarët e komunës së Istogut kanë merituar vizita të shpeshta nga përfaqësuesit më të lartë qeveritarë dhe kanë merituar mbështetjen më të madhe financiare për t'i riparuar dëmet, por kjo nuk ndodhi, as që do të ndodhë e si duket as që do të ndodhë.

Komuna e Istogut në vazhdimësi udhëhiqet nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Ajo është njëra nga bastionet kryesore të LDK-së, por kryeministri duhet të dijë se është kryeministër i Kosovës dhe i gjithë qytetarëve të Kosovës dhe nuk duhet të bëjë dallime të tilla duke i mbështetur komunat në bazë partiake.

Mbështetja që i është dhënë komunës së Istogut, për t'i riparuar dëmet, është qesharake dhe Qeveria nëse pretendon se është Qeveri e gjithë qytetarëve të vendit tonë, atëherë duhet t'i rishqyrtojë vendimet për mbështetje financiare për Istogun, përndryshe vendimi i marrë më herët konsiderohet se është vendim politik, partiak, që është kundër qytetarëve të komunës së Istogut të cilët po pësojnë dhe ajo duhet të mbështetet nga Qeveria ... më shumë, se kjo Qeveri nuk i mbështet, dhe më herët thashë, që e udhëheq Lidhja Demokratike e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Ne emër të Grupit Parlamentar "Vetëvendosje" e ka fjalën deputeti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Parlamenti i Serbisë ka marrë vendim që zgjedhjet e veta t'i mbajë edhe në Republikën e Kosovës. Kjo na qenka pra Serbia Evropiane. Serbia e mban Kosovën të ndarë territorialisht përmes strukturave të veta të paligjshme të cilat i kontrollon dhe i financon, Serbia e mban veriun të barikaduar, Serbia e mban peng pakicën serbe të pa integruar, Serbia i mban zgjedhjet në Republikën tonë dhe shkakton dhunim të sovranitetit të shtetit të Kosovës dhe përkundër të gjitha këtyre, Serbia e merr statusin e vendit kandidat për hyrje në Bashkimin Evropian.

Qysh është e mundur kjo, shtrohet pyetja? Kjo është e mundur për sa kohë ne kemi qeveri e cila po duket se punën më të mirë që di ta bëjë, është të shtrojë qilima të kuq për Serbinë, drejt hyrjes në Bashkimin Evropian.

A po më tregoni, deputetë të nderuar, çka ka hequr dorë Serbia prej Kosovës që e fitoi statusin e vendit kandidat për Bashkimin Evropian? Unë po them ajo nuk ka hequr dorë bash asgjë.

Asaj po i mundësohet njëra këmbë në Bashkimin Evropian e tjetra me zgjedhje e me struktura kriminale në veri. Kështu do të jetë derisa të kemi qeveri servile dhe të shantazhueshme ndaj ndërkombëtarëve, kurse qyqare ndaj Serbisë. Zgjedhjet serbe janë një turp i madh për Qeverinë e Kosovës, por po aq turp janë edhe për vetë Bashkimin Evropian.

Edhe BE-ja duhet të mendojë se si mund t'ia japë vendin e statusit kandidat një shteti, i cili shtetin tonë, që e ka njohur 23 shtete të Bashkimit Evropian e ka në Kushtetutën e vet, kurse në anën tjetër mban zgjedhje në Republikën tonë.

Serbinë nuk po e kushtëzon bash asgjë, as Qeveria jonë e saj Bashkimi Evropian, kjo është fatkeqësi, sepse hajde ta zëmë se Serbisë po i jepej një shpërblim ashtu që të heqë dorë prej veriut, por sa më afër Bashkimit Evropian, Serbia aq më thellë në veriun e Kosovës.

Pozicioni politik i Qeverisë sonë ndaj Serbisë dhe zgjedhjeve të saj në territorin tonë, mund të vendoset diku ndërmjet qyqarllakut edhe mjerimit.

Me reagimin e tyre Qeveria ka treguar se çka do të bëjë më 6 maj. Ajo do t'i dënojë zgjedhjet e Serbisë më deklarata. Pra, qasja e Qeverisë ndaj veriut është deklarative. Bile edhe më të mira janë do reagime që po i dëgjoj prej ministrave të ndryshëm, të cilët po e vajtojnë fytyrën e Serbisë. Këta u lodhën duke fol për fytyrën e Serbisë, ndërkohë ajo e mori statusin e vendit kandidat në BE, kurse për Kosovën, përmendet kryesisht për korrupsion, drejtësi të kontrolluar e mungesë të sundimit të ligjit. Boll më me kësi kujdestarë ndaj fytyrës së Serbisë, se fytyrën e Serbisë ne e dimë. Ne nuk kemi nevojë ta vajtojmë fytyrën e Serbisë, por ta mbrojmë Republikën e Kosovës. Prandaj, sovraniteti dhe shtetësia e kushtetutshmëria, ushtrohen me veprime konkrete. A ka më mjerim të madh se sa për t'i kundërshtuar zgjedhjet e Serbisë, këta thirren në Rezolutën 1244?

Sa herë që janë mbajtur zgjedhjet e Serbisë në Kosovë, Qeveria ka premtuar se këto do të jenë të fundit, ky është recitim i propagandës. Tash Qeveria po përgatitet të hyjë në negociata edhe për veriun, por qytetarët duhet ta dinë se territori i Republikës sonë dhe bashkimi i Kosovës, nuk mund të ndodhë, pa ndodhur fundi politik i kësaj Qeverie. Me këtë Qeveri në pushtet, vetëm një rezultat është i garantuar, e kjo është autonomia e veriut.

Deri tash, Qeveria i ka thënë jo negociatave për Veriun, por nëse kjo jo është sikur "jo" e fusnotës, atëherë unë po them vaj halli për neve.

KRYESUESI: Faleminderit!

A ka dikush në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së që është paraqitur? Atëherë Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të nesërmen, kur Kosova shpalli pavarësinë, imazhi i obeliskut "Newborn", pati zënë në ballinën e gazetës New York Times, pra gazetës ndër më precioze në botë, reklamë pa pagesë ishte kjo për faktin se fotoja e obeliskut i bashkëngjitej raportit të gazetës më të madhe amerikane, që e publikonte për lindjen e shtetit më të ri në botë.

Katër vjet më pas, obelisku i vendosur para Pallatit të Rinisë në Prishtinë, u shfaq sërish, por kësaj radhe jo vetëm në Amerikë, por në gjithë globin, tash përmes kanalit të televizionit gjithashtu ndër më prestigjiozet në botë, CNN.

Por një deformim ia ndryshoi në tërësi leximin, ngjyrosja në të kaltër e gjysmëharkut të poshtëm të shkronjës “B” bëri që obelisku të lexoj ndryshe. Kështu u skandalizua imazhi i monumentit më kulmor të shtet krijimit.

Ndërsa, pamja e shëmtuar e obeliskut me këtë deformim u përzgjodh të transmetohej në sekondën e 11 të spotit 15 minutash, të financuar nga Qeveria e Kosovës.

Zëvendëskryeministrja Mimoza Kusari Lila, kërkoi nga televizioni prestigjioz, ndryshimin e reklamës pas gabimit aq të madh, mirëpo ende sot e kësaj dite nuk u kërkoj falje qytetarëve të Kosovës, për lëshimin skandaloz të ekipit së ekspertëve, së paku 20 veta, siç thotë ajo, apo atyre që e mbikëqyrën reklamën. Pra, është dashur që gabimi të vërehej fillimisht nga qytetarët e pastaj të reagohej.

Pastaj vetë përmbajtja e spotit, Kosovë e re, me pamje të vjetra, përsëri skandaloze dhe e papranueshme. Kush në fakt e bartë përgjegjësinë për këto lëshime? Në reklamë shohim njerëz të rinj, por jo qytetarë të Kosovës, sërish e papranueshme dhe për më tepër nënçmuese për rininë tonë të shkëlqyeshme dhe me plotë vizion.

Në vërejtjet që gjatë kësaj kohe iu bën zëvendëskryeminstres për prezantimin e të rinjve, që në fakt nuk janë kosovarë, ndërsa ajo thotë se njerëzit që janë paraqitur në këtë spot është dashur të prezantojnë një qetësi, një normalitet, një lumturi të rinjve në Kosovë, pa e ditur edhe vet se a janë kosovar apo jo, ku ndoshta ka të drejtë Mimoza, kur thotë se të rinjve të Kosovës po u venitet pak nga pak buzëqeshja nga ndjenja e lumturisë, nga “mirëqeverisja” në vend dhe nga papunësia dhe perspektiva e çdo ditë e më zymtë për ta. Pastaj Kosova nuk paraqitet në disa momente edhe me pamje origjinale të saja. Zëvendëskryeministrja arsyetohet se pak persona i dinë këto detaje, çfarë t’i themi kësaj, këtij arsyetim qesharak, në fakt ajo tallet me tatimpaguesit kosovarë të cilët duhet të paguajnë për njerëz të tjerë e jo për fëmijët e tyre.

Zëvendëskryeministrja nuk e pranon gabimin, për më tepër thotë se prej fillimit kur reklama është bërë publike, ka pasur qasje transparente. Nëse është kështu, atëherë unë pyes se çfarë niveli ka qenë kjo transparencë edhe kush janë ata ekspertë që e kontrolluan apo e mbikëqyrën reklamën?

Përse zëvendëskryeministrja e mbron me aq pompozitet CNN-in, i cili në fakt bëri lëshimin final në spotin publicitar për Kosovën, televizion i cili në fakt është dashur të ndëshkohet dhe për këtë gabim trashanik, sepse edhe kanali televiziv më i dobët vështirë se do ta bënte këtë lëshim.

Ajo ndihet e lumtur që spoti është shfaqur në 4 vjetorin e Pavarësisë, ndërsa unë e them edhe një herë me përgjegjësi që Kosovën në 4 vjetorin e Pavarësisë është paraqitur në gjithë globin me anti-reklamën më të madhe të mundshme.

Mirëpo, problemi më i madh është te paratë e dedikuara për këtë reklamë. Para 2 apo 3 viteve, siç jemi të gjithë në dijeni, u shpenzuan 5.7 milionë euro për këtë qëllim.

Qytetarët me të drejtë pyesin- A ja ka vlejtur thjesht e gjithë kjo shumë e shpenzuar dhe cilat ishin efektet pozitive të këtij publiciteti? Pra, shumica prej tyre mendojnë se rezultatet kanë qenë zero. Sa shtete apo a ekziston, qoftë edhe një shtet i vetëm që e njohu pavarësinë e Kosovës, falë këtij publiciteti? Unë nuk kam lexuar apo dëgjuar të ketë ndodhur diçka e tillë.

Dhe, krejt në fund për sa i përket kësaj teme, unë me zëvendëskryeministren pajtohem vetëm në një pikë, që ai apo ata që kanë ngjyrosur shkronjën në “Newborn” e kanë bërë për motive tepër të ulëta dhe krejtësisht të papranueshme për shoqërinë tonë. Ndërsa, të gjitha arsyetimet e tjera nuk qëndrojnë edhe së këndejmi ajo natyrisht që duhet t’u kërkojë falje sado e vonuar qoftë gjithë qytetarëve të Kosovës dhe natyrisht edhe ideatorit të “Newborn” në Prishtinë. Në një shtet të lirë e demokratik, dorëheqja e bartësit të përgjegjësisë, do të duhej të ndodhte patjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Damka!

FIKRIM DAMKA: Teşekkür ederim sayın Meclis başkan yardımcısı,
Sayın başbakan, sayın bakanlar ve mevkidaşlarım,

Kosova’nın bugün hedefi olan dünya ekonomik boyutlarına ulaşmak, Kosova’da ekonomik düzeyinin yükseltilmesi ve işsizliğin düşürülmesine yönelik tek kaynak olarak özel sektörün teşvik edilmesi ve ilerletilmesi sayesinde sağlanabilir.

Özel sektörden toplanan vergiler, aslında devlet kalkınmasını destekleyen ve körükleyen, ana kaynaklarından en önemlisidir.

Devletin özel sektörden vergi toplaması ve güvenli bir kaynak yaratması son derece önemli. Çünkü Avrupa Birliği Komisyonu’nun Kosova’ya ait İlerleme Raporu’nda da gelişmiş bir vergi toplama sisteminin uygulanmasından elde edilen yararlaradır.

Bugün özel sektör yani esnafımız, vergisini düzenli ödemekte ve devlete olan borcunu ertelemekten layıkıyla karşılamaktadır. Bunun en iyi örneği geçen yıl uygulanması zorunlu kılınan fiskal kasaların özellikle Prizren esnafı tarafından benimsenerek satın alınmış olmasıdır.

Çevre ülkelere kıyasla Kosova’da en pahalı satılan ve buna rağmen satın almaya razı olan Etnafımız bu günlerde yeni bir zorlukla karşılaşmaktadır. Karşılığında 700 Euro ödedikleri Fiskal kasaları için esnafımız yıllık bakım parası da ödeme mecburiyetinde kaldı. Bu kasalarda hiç bir arıza olmamasına rağmen tekel şirketler Esnaftan bakım parası olarak ayda en az 60 Euro havadan para almaktadır.

Bu sıkıntı yetmezmiş gibi Vergi Dairesine ayda bir göndermekle yükümlü oldukları en pahalı mesaj masrafına da katlanmak zorunda kalan esnaf, bunun için ayda daha 4 Euro cebinden çıkarmalıdır. Oysa Esnafın bu ödemeleri yıllık gelir olarak doğrudan bakım şirketinin kasasına giriyor. Nedense fiskal kasa sahipleri nedenini bilmeden zar zor kazandığı gelirlerinden ayda 100 Euro ayırmak zorunda bırakılmıştır.

Böylece gelir vergisi mükellefi olan Esnaf, şerefli davranışı karşısında haksız olarak cezalı konumuna düşürülmektedir.

Zaten zor durumda olan esnafı bu kadar zorlamakla Kosova özel sektörünün ilerletilmesinin mümkün olmayacağını ve bu uygulamalar sürerken, yabancı yatırımcıları asla celp edemeyeceğimizin farkına varmalıyız.

Ekonomi ve Maliye Bakanlığı'nın bu konudaki yaklaşımını bir daha gözden geçirmesini Esnaf adına talep etmeyi borç biliyorum. Sağol.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Ganimete Musliu e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Pas vendimit të Shoqatës së Transportierëve për ngritjen e çmimit të biletave për studentë, studentët e Universitetit të Prishtinës kanë shprehur pakënaqësitë e tyre në forma të ndryshme dhe kanë bërë apel në uljen e çmimeve të biletave për studentë. Pasi që kjo çështje ka sjell shumë probleme ekonomike në familjet e studentëve dhe ka krijuar vështirësi në mbarëvajtjen e studimeve, pas reagimeve, konferencave, deklaratave, protestave nga studentët, Organizata Paqja Studentore, i është drejtuar me një kërkesë edhe Grupit Parlamentar të deputetëve të rinj, për t'i përkrahur studentët dhe për të bërë thirrje edhe përmes Kuvendit, që të merren në konsideratë kërkesat e studentëve për uljen e çmimit të biletave.

Grupi i deputetëve të rinj e vlerëson lartë kontributin e Shoqatës së Transportierëve që ka dhënë me dekada, në bartjen, pa asnjë çmim të kategorive të ndryshme, siç janë: studentët, policia, ushtarët, mësimdhënësit e të tjera. Gjithashtu jemi të vetëdijshëm edhe për koston që kanë kompanitë e udhëtimit duke pasur parasysh lëvizjen e çmimit të derivateve. Por njëherit si grup i deputetëve të rinj të Parlamentit të Kosovës, apelojmë edhe një herë që kërkesat e studentëve të merren parasysh dhe të gjendet një mundësi për uljen e çmimeve të biletave, qoftë edhe për fundjavë kur ata kanë nevojë pa tjetër që të shkojnë në familjet e tyre. Faleminderit, shumë për respekt!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Vjosa Osmani e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Para një jave është bërë një vit nga fillimi i dialogut midis Kosovës dhe Serbisë. Injorimi që Qeveria i bëri Kuvendit u pa qysh në fillim, me faktin që dialogu filloi dy ditë para se të miratohet rezoluta e Kuvendit, që e përkrahte këtë dialog. Përkundër kësaj, Kuvendi përmes kësaj rezolute paraqet obligime të qarta për Qeverinë në këtë dialog, asnjëra prej të cilëve nuk janë respektuar gjatë këtij viti.

Të nderuar kolegë,

Jo rastësisht, Raporti i Progresit i Bashkimit Evropian, potencon se ndikimi i Qeverisë në Kuvend është aq shqetësues sa që Kuvendi nuk po mundet as ta luajë rolin e vetë kushtetues për mbikëqyrje të Qeverisë. Dëshmia më e qartë e kësaj është shkelja nga ana e Qeverisë e Rezolutës së Kuvendit për dialogun e datës 10 mars të vitit të kaluar.

Po filloj me paragrafët veç e veç të qartësohet se cilat pika janë shkelur edhe besoj që të gjithë do ta kemi të qartë, përfshirë Qeverinë.

Kjo rezolutë obligon raportimin e rregullt të kryenegociatores Tahiri në Kuvend, më 10 mars janë bërë një vit që kur është miratuar kjo rezolutë dhe gjatë këtyre 12 muajve ajo është paraqitur para Komisionit funksional vetëm një herë. Do të thotë, për një vit, për më shumë se një marrëveshje të gjitha, natyrisht, në dëm të Kosovës, është paraqitur në Komisionin funksional vetëm një herë.

Pika e 6 e Rezolutës për dialogun mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, shprehimisht thotë: “E emëruara nga kryeministri, udhëheqëse e delegacionit të Republikës së Kosovës, për dialogun me Republikën e Serbisë, do të informojë në baza të rregullta Komisionin për Politikë të Jashtme dhe komisionet tjera përkatëse të Kuvendit të Kosovës dhe do të raportojë edhe në seancë plenare të Kuvendit të Kosovës”. Qeveria e di shumë mirë, madje edhe kryenegociatorja Tahiri, që raportimi dhe debati janë dy kategori të ndryshme kushtetuese dhe po ashtu dy kategori të ndryshme sipas Rregullores së Punës së Kuvendit. Prandaj Qeveria nuk duhet të presë që deputetët të iniciojnë debat edhe pse kjo gjë është bërë disa herë, por këtë çështje e ka obligim për raportim sipas Rezolutës. Madje edhe sikur të mbaheshin debate çdo ditë në këtë Kuvend, për çështjen e dialogut, kjo në aspektin juridik nuk e konsumon detyrimin e Qeverisë për raportim në Kuvend.

Për më shumë, thuajse të gjitha dispozita tjera të kësaj rezolute janë shkelur, përfshirë edhe kompetencat e qarta se për çka mund të bisedojë Qeveria në tavolinë me Serbinë.

Po fillojmë nga paragrafi 4 i kësaj rezolute që thotë: “Agjenda e dialogut do të përfshijë vetëm çështje teknike”. Ky obligim i Rezolutës është shkelur qysh nga fillimi i procesit dhe kjo tashmë u confirmua edhe nga lehtësuesi i dialogut zoti Cooper, i cili jo vetëm që....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe dy minuta i ka, se në emër të Grupit, regjia.

VJOSA OSMANI: Deklarimi i fundit i zotit Cooper, jo vetëm demantoi Qeverinë, por edhe i përqeshi deklaratat e shumta, se kinse qenka diskutuar për çështje teknike e jo për çështje politike.

Më tej, paragrafi 3 i po kësaj Rezolute thotë se dialogu do të jetë i përgatitur mirë, me agjendë të qartë dhe të përcaktuar paraprakisht, ndërsa paragrafi 5 thotë se obligohet Qeveria, që t'ia paraqetë Kuvendit, dokumentin themelor të dialogut, brenda afatit ligjor.

Ka kaluar një vit, ku është ai dokument?

Prandaj, është plotësisht e natyrshme, që kryenegociatorja Tahiri, nuk ka gjetur kurajën që deri tani të paraqitet para Kuvendit, për të treguar dështimet e saj dhe procesin jashtëzakonisht të dëmshëm që po e udhëheq.

Ne kemi thënë që nga fillimi, se ky dialog ka qenë politik e jo teknik, por fatkeqësisht Qeveria tani po e shndërron atë edhe në dialog për statusin e pjesës veriore të Kosovës.

Kryenegociatorja në vend se të japë përgjegjësi politike për dështimet në këtë proces, deri tani është fshehur në shtetet tjera. Udhëtimet e saj në shtete, të cilat më së paku kanë të bëjnë me procesin e dialogut, siç është Kanadaja, tregojnë se objektivi primar është jo që të mbrohen interesat e Kosovës në këtë proces, por mëditjet e shumta që i shkojnë në dëm buxhetit të Kosovës.

Në njëvjetorin e dialogut, ajo ka zgjedhur që të festojë dështimet e Kosovës në këtë proces për 8 Mars, me koleget e saja në Shqipëri.

Në fakt, për fund, unë do t'i rekomandoja asaj që as mos të kthehet fare, kur të shkojë në udhëtimin e saj të ardhshëm, sepse puna e saj vetëm i ka sjellë dëme Kosovës.

Është momenti i fundit që Kosova të kushtëzojë pjesëmarrjen e saj të mëtejme në këtë dialog, me mosndërhyrje të Serbisë në punët e brendshme të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Shaip Muja, e ka fjalën!

SHAIP MUJA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Ministra të Republikës së Kosovës,

Një temë, të cilën unë do ta riaktualizoj, nuk do të flas për kontaminimet politike, por do të flas për kontaminimet ambientale, të cilat janë duke ndodhur në Republikën e Kosovës.

Konkretisht, nga informacionet të cilat janë duke rrjedhur dhe duke u parë në aspektin praktik kontaminuesit e mëdhenj, siç janë Feronikeli, është Sharrçemi, deponitë e ndryshme në „Trepçë“ dhe deponi tjera, të cilat i shkakton edhe Termoelektrana e Kosovës, duhet të jetë një shqetësim më i lartë i Qeverisë dhe i dikastereve të ministrive përkatëse, të cilët duhet të jenë të involvuar në ndalimin dhe sanimin e kësaj gjendjeje.

Unë i kam ngritur disa herë këto çështje, kjo është një çështje e cila kërkon një angazhim të shumë ministrive: Ministrisë së Ambientit, Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Tregëtisë dhe Industrisë dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Ne jemi dëshmitarë, ku këto ekonomi të cilat nuk janë duke u menaxhuar mirë, çfarë teknologjish janë duke përdorur, është në përgjegjësinë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, po ashtu edhe të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, ndërsa, Ministria e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, përveç dënimeve të cilat i ka, i quan dënime, të cilat i quan si kundërvajtëse, ndërsa unë kam shtruar pyetje disa herë, nëse një kundërvajtës disa herë bën kundërvajtje të tilla, a hyn në problem penal apo hyn në kundërvajtës?

Prandaj, këto institucione ne nuk jemi për t'i ndaluar, siç janë pretendimet e disa partive politike, që t'i politizojnë, por që të mobilizohet grupi edhe parlamentar përkatës i Parlamentit, së bashku me ata që duan të kontribuojnë. Unë jam i gatshëm që të kontribuoj pozitivisht me të gjitha kapacitetet e mia personale dhe institucionale, që t'iu ndihmojmë këtyre kompanive, të punojnë mirë, t'i shfrytëzojnë mirë kapacitetet minerale, të cilat janë duke i përdorur, por mos të kontaminojnë ambientin dhe të mos dëmtojnë.

Po ashtu, kam ngritur shqetësimet që të ngritet një komision për analizën e ambientit të tokës, ujit, ajrit dhe personave në afërsi të këtyre ambienteve, të shihen sa janë të kontaminuar.

Prandaj, Republika e Kosovës nuk ka buxhet, që t'i shërojë ato dëme të cilat i shkakton ambienti i dëmtuar nga këto kompani, të cilat në njëfarë mënyre nuk janë treguar të përgjegjshme konform standardeve që i kërkon edhe Bashkimi Evropian, por që është edhe intenca e Republikës së Kosovës.

Në Feronikel, janë duke ndodhur disa incidente, të cilat duhet të jenë edhe stafi menaxherial më i përgjegjshëm, duke ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,
Ajo që kohëve të fundit po ndodhë në Maqedoni, incidentet e vazhdueshme, ku kohë më parë u vranë dy shqiptarë nga një polic maqedon, rrahja e nxënësve shqiptarë në autobus e incidente të tjera, vërejmë se po injorohet nga Prishtina e Tirana.

Dhe, aq shpesh, duke dëshiruar të paraqiten si incidente spontane, apo si të izoluara e që ndodhin si pasojë e dallimeve etnike dhe ku shteti maqedon nuk ka të bëjë me to.

Shqiptarët në Maqedoni shtypen nga shteti maqedon dhe incidente të tilla, madje edhe sikur të mos ishin të organizuara drejtpërdrejt, ato janë fryt i shovinizmit maqedon, që shteti maqedon i fryn tash sa vite. Atje shteti e nxiti dhe po vazhdon ta nxisë shovinizmin antishqiptar. Dhe, kjo që po ndodh është fryt i drejtpërdrejtë i kësaj politike, që fillon nga

Akademia Maqedone, me fyerje përmes Enciklopedisë, nëpërkëmbja e vlerave kulturore shqiptare, karnavalet e organizara antishqiptare e deri te vrasja e veprimtarëve shqiptarë.

Më e keqja është se gjatë tërë kësaj kohe, Prishtina ka heshtur e madje ka ndodhur që të jetë edhe në anën e krimit, kur më 12 maj 2010 u vra veprimtari Harun Aliu, ministri Rexhepi deklaronte se kemi bashkëpunim të mirë me Maqedoninë dhe pas takimit me homologët maqedon, menjëherë pas vrasjes misterioze, ku Harun Aliu paraqitej si kontrabandist armësh.

Pra, kjo politikë e nxitjes së urrejtjes kundër shqiptare merrte dhe merr krah edhe nga heshtja e Prishtinës dhe Tiranës.

Dhe, tani kur si fryt kemi dhunën e shfrenuar edhe më tutje, synohet të amnistohet shteti maqedon.

Edhe para kësaj nuk bën të heshtet, pasi nuk është e drejtë. Shqiptarët vazhdojnë të bartin stabilitetin e Ballkanit, mbi kurriz të tyrin dhe si shpërblim për këtë e kanë shtypjen e vazhdueshme dhe pse kjo ndodh tani? Shumë thjeshtë, sot shqiptarët janë më të dobët se që ishin para dhjetë vjetësh dhe sot maqedonët janë shumëfish më të fortë dhe më shovinistë se që ishin para dhjetë vjetësh. Për dhjetë vjet rresht shqiptarët që organizohen dobësohen e përçahen dhe për dhjetë vjet rresht shteti maqedon forcon dhe ushqen shovinizmin ndaj shqiptarëve.

Dhe, tani jemi në pikën kur shqiptarët përdhe përballen me shtetin maqedon të mbushur urrejtje kundrejt tyre. Për dhjetë vjet rresht edhe ajo marrëveshje që ishte, nuk u implementua, edhe pse as për së afërmi nuk i plotëson kërkesat e shqiptarëve. Të mos harrojmë, atë marrëveshje shqiptarët e nënshkruan për hir të stabilitetit dhe tani kur ata janë të dobësuar fare, fillon dhunë ndaj tyre.

Dhe, Prishtina heshtë, hesht se edhe ajo është bartëse e një politike, e cila dobëson potencialin shqiptar. Ne po dobësohemi gjithandej, ne po shtypemi gjithandej, ndërsa faktori politik shqiptar e ka reduktuar projektin e vet politik në ruajtjen e pushtetit dhe jo në mbrojtjen e shqiptarëve. Shqiptarët po shtypen dhe dëbohen dhe po e humbin hapësirën ku jetojnë dhe kjo po ndodh edhe përkundër faktit, që janë të dëgjueshëm, edhe përkundër faktit që stabilitetin e rajonit po e mbajnë mbi kurriz. Edhe para kësaj nuk bën të heshtet.

KRYESUESI: Faleminderit!

Diskutimi i fundit, deputetja Kymete Bajraktari.

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Konkurrenca jolojale për prodhuesit vendorë në raport me prodhuesit e shteteve, të cilat janë nënshkruar të marrëveshjes së CEFT-as, është faktor i cili dëmton në masë të madhe prodhuesit vendor dhe buxhetin e Kosovës. Serbia dhe Bosnja, të cilat janë anëtare të

CEFT-as, në ligjin e vet të prokurimit parashohin mbrojtjen e prodhuesve vendor, ku në Serbi e kemi deri në 20%, ndërsa në Bosnjë 12%.

Nëse në një tender të shpallur në Serbi konkurren një kompani vendore dhe kompanitë nga shtetet tjera anëtare të CEFT-as, sipas Ligjit të prokurimit të Serbisë, kompania vendore, edhe nëse konkurren me çmim 20% më të lartë se të tjerët, e fiton tenderin. Në këtë rast nuk respektohet marrëveshja e CEFT-as.

Kjo nuk ndodh në shtetin e Kosovës.

Prodhuesit tanë, jo që nuk janë të favorizuar, por ata janë të dëmtuar. Për shembull, nëse KEK-u ka hapur një tender, të drejtë konkurrimi kanë të gjitha shtetet fqinje anëtare të CEFT-as. Dhe, nëse tenderin e fiton një kompani nga shtetet fqinje, e cila ka ofruar 1% më të lirë se kompania vendore, atëherë buxheti i Kosovës do të dëmtohet 10%, për shkak të doganave në repromaterial, 10% është tatimi në fitim, pastaj janë kontributet, që paguhen për punëtorët. Të gjitha këto dëmtojnë buxhetin e Kosovës dhe qytetarët e saj.

Problem tjetër, me të cilin duhet të merret Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, është që t'i aplikojnë masat e reciprocitetit. Përderisa kompanitë e shteteve fqinje, kryesisht kompanitë nga Serbia, vijnë në Kosovë dhe iu bëjnë konkurrencë prodhuesve tanë pa asnjë problem, edhe pse i shkaktojnë dëm buxhetit të Kosovës, kjo nuk ndodhë me kompanitë tona, të cilat edhe nëse i përshtaten ligjeve të prokurimit, ato nuk kanë të drejtë të konkurrojnë direkt, sepse këto kompani duhet të jenë të regjistruara, domethënë, të licencuara si biznese në Serbi. Ato janë të detyruara të konkurrojnë në mënyrë indirekte, që u shkakton kosto shtesë.

Nëse Qeveritë e këtyre shteteve kanë vepruar në mbrojtjen e prodhuesve vendor, çfarë bën Qeveria jonë karshi këtyre pengesave, që iu bëhen prodhuesve tanë?

Andaj, kërkojmë nga Qeveria, që të bëjë presion, që të respektohen rregullat e marrëveshjes se CEFT-as nga të gjitha shtetet nënshkruese, nëse jo, kjo Qeveri të hartojë politika, të cilat do ta mbrojnë dhe favorizojnë prodhuesin vendor.

Dhe nën dy, respektimin e masave të reciprocitetit në kushte të konkurrimit. Nëse shtetet tjera kërkojnë regjistrimin e bizneseve si biznese të shteteve të tyre, e njëjta kërkesë të bëhet edhe nga shteti ynë, konkurrim në kushte të barabarta për të gjithë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Po, në emër të Qeverisë, kryeministri ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, z. HASHIM THAÇI:

Faleminderit!

I nderuar nënkryetar i Parlamentit, zoti Haliti,

Kabinet Qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që të theksoj, sa i përket çështjeve që u ngritën edhe sot këtu, se Kosova ka një qëndrim unik edhe sa i përket pretendimit serb për organizimin e zgjedhjeve në Republikën e Kosovës. Prandaj, konkludojmë se Republika e Kosovës nuk do të lejojë asnjë shtet tjetër fqinjë, apo të ashtuquajtur përfaqësues të tij, që të organizojë zgjedhje të çfarëdo lloji në territorin e Republikës së Kosovës.

Ky është qëndrim unik i Qeverisë së Kosovës, institucioneve të Kosovës dhe vullnet i të gjithë qytetarëve dhe partive politike.

Ndërsa, në anën tjetër, dëshiroj të theksoj, gjithashtu, se sa i përket ideve apo zërave të ndryshëm, që paraqiten aty- këtu për ndonjë dialog për veriun e Mitrovicës, e them shumë qartë, veriun e Kosovës, e them shumë qartë se një dialog i tillë as nuk ka ekzistuar, as nuk ekziston dhe as që nuk do të ndodhë, por, takime, kontakte, dialog i brendshëm me qytetarët shtetas të Republikës së Kosovës, që jetojnë në atë pjesë të Kosovës, për t'i dëgjuar hallet dhe shqetësimet e tyre, ka pasur, do të ketë edhe në të ardhmen, në mënyrë që të integrohen dhe të marrin pjesë në institucionet e Republikës së Kosovës, por në asnjë rrethanë, me asnjë çmim me Serbinë.

Prandaj, edhe pretendimet që paraqiten aty-këtu për ndonjë autonomi apo status special, nuk janë të vërteta, janë të paqëndrueshme dhe nuk do të ndodhin. Edhe sa i përket pretendimit për ndryshime të kufijve apo pretendimeve territoriale, unë e kam bërë edhe të qartë, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, gjithë miqve ndërkombëtarë mesazhin e institucioneve dhe qytetarëve të Kosovës, se me pretendime të tilla të ndryshimit të kufijve, shqiptarët më së miri dhe më së lehti mund të jetojnë në një shtet të vetëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, që është

2. Koha për pyetja parlamentare.

Në pajtim me nenin 45, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është kufizuar në 60 minuta. Deputeti për një mbledhje nuk mund të parashtojë më shumë se dy pyetje.

Radhën e ka deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Buja. Nuk është.

Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Ramë Buja.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Po, pyetja ka qenë se kur do të hapet konkursi për studime në doktoraturë, mirëpo në ndërkohë është hapur konkursi, kështu që veç përgëzoj që ky proces të rrjedhë mirë, normalisht dhe të jetë një proces i drejtë dhe i paanshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Alma Lama, pyetje për zëvendëskryeministren Edita Tahiri.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe pse kanë kaluar 12 vjet pas përfundimit të luftës, rreth 1.800 persona vazhdojnë të rezultojnë të humbur. Ata janë viktimat e policisë dhe ushtrisë serbe, të cilët i kanë marrë nga familjet e tyre dhe s'i kanë kthyer kurrë më. Të gjitha përpjekjet institucionale deri tani kanë dështuar, pasi shteti serb nuk ka gatishmëri për të zbardhur të vërtetën rreth fatit të këtyre personave, e vërtetë e cila inkriminon këtë shtet.

Përpara se të fillonin bisedimet të ashtuquajtura teknike, me Serbinë, por që sot fare qartë u pa se janë politike, sipas deklaratës së zotit **Cuper** dhe sipas asaj që kemi thënë ne, është premtuar se kthimi i të pagjeturve do të jetë temë e dialogut.

Sado që ky nuk është problem teknik dhe duket shumë johumane të trajtohet si çështje teknike, Qeveria e Kosovës, as këtë nuk e ka bërë.

Prandaj, unë pyes zonjën Tahiri se përse deri tani në dialogun me Serbinë nuk e keni futur në agjendë dhe nuk keni kërkuar kthimin e 1.800 personave të pagjetur?

KRYESUESI: Faleminderit!

Zonja Tahiri, e keni fjalën!

EDITA TAHIRI: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar Kabinet Qeveritar,

Deputetë të nderuar,

E nderuar deputete Lama,

Më lejoni t'ju them se nuk jeni të informuar me rrjedhat e dialogut lidhur me çështjen e personave të pagjetur.

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Urdhëroni!

EDITA TAHIRI: Më duket se Alma ka bërë pyetje, unë po jap përgjigje.

KRYESUESI: Po, po.

EDITA TAHIRI: Apo jo! Po, edhe unë, po s'po di, Alma, me LDK-n s'i paske punët mirë. Megjithatë...

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Ju lutem keni parasysh kohën, sepse minutazhi është i kufizuar për përgjigje.

EDITA TAHIRI: E nderuar deputete Lama, si duket nuk jeni të informuar me rrjedhat e dialogut, lidhur me çështjen e personave të pagjetur, sepse çështja e të pagjeturve është

shtruar në dialogun teknik në Bruksel, me kërkesën e Qeverisë së Kosovës dhe ka qenë në agjendën e raundit të katërt të mbajtur më 18 maj 2011.

Në këtë takim ne kemi paraqitur qëndrimet tona për zgjidhjen e çështjes së të pagjeturve, si një problem i pazgjidhur tash 13 vjet dhe si një nga plagët më të rënda të shkaktuara nga lufta.

Kërkesat tona konkrete kanë qenë:

1. Që BE të marrë rol udhëheqës dhe garantues për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së personave të pagjetur, duke qenë se janë edhe 1.800 persona të zhdukur,
2. Të hapen arkivat e ish-ushtirisë jugosllave dhe të institucioneve tjera të përfshira në operacionet luftarake në Kosovë, për periudhën e viteve të luftës si dhe të viteve të paraluftës, në rastet ku përmbajtja e dokumenteve ndërlidhet me informata të besueshme rreth zgjidhjes së çështjes në fjalë,
3. Të sigurohet qasje në dokumente relevante, që në bazë të informacioneve tona janë të besueshme dhe këto dokumente do të ofronin përgjigje për çështje si vijon:
 - Vendndodhjen e personave të zhdukur,
 - Vendvarrimet tjera të jashtëligjshme apo klandestine, me mbetje mortore të viktimave të luftës, si dhe
 - Informata mbi fshehjen e gjurmëve, duke përdorur furnaltat për djegien e trupave e të tjera,
4. Të përshpejtohet procedimi i mëtutjeshëm i rasteve të parashtruara me kërkesë zyrtare, siç janë rasti i Rashkës, i Medvegjës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë! Mirë de, po mos u merr me të tjerët, merru me përgjigjen që e ke. Ti s'ke punë me të tjerët! Edhe një minutë!

EDITA TAHIRI: Edhe një minutë, të lutem!

KRYESUESI: Të lutem!

EDITA TAHIRI: Po ashtu, kemi shtruar kërkesë për ndriçimin e fatit të profesor Ukshin Hotit, si një intelektual dhe veprimtar i shquar i çështjes kombëtare si dhe kemi kërkuar, që çështja e të pagjeturve të trajtohet me konventa ndërkombëtare, si çështje humanitare e jo si çështje politike.

Dhe, në fund, Alma më lejoni të them se Robert Coperi nuk vendos në emër të Kosovës, për çfarëdo bisedimesh, vendos populli i Kosovës dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Lama, pyetje shtesë.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Në fakt, Kosova është rasti unikal, ndoshta në botë dhe më i keqi, ku populli nuk pyetet për vendimet që merren në emër të tij, e gjitha është demagogji.

Zonja Tahiri, sigurisht që ne deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk jemi të informuar për atë se çfarë bisedoni ju në Bruksel, sepse nuk na keni njoftuar asnjëherë dhe ne nuk mund të bëjmë fall se çfarë bisedoni, në qoftë se ju nuk na informoni.

Tani, në rast se ju e paskët diskutuar këtë çështje, cili është rezultati, çfarë keni arritur pra, nëpërmjet bisedimeve atje? Kjo e para dhe e dyta- pse keni kaluar në tema të tjera, pa u zgjidhur çështja e të zhdukurve, personave të pagjetur, ndërkohë që qëndrimi jonë është fare i qartë dhe jo vetëm i joni po i krejt popullit të Kosovës, ju nuk do të duhej të kishit hyrë në dialog, pa u zgjidhur kjo çështje, pa u kthyer të pagjeturit? Nuk mund të bisedosh me agresorin, kur ai ende i ka viktimat e tua aty, brenda shtetit të vet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zonja kryeministresh, fjalën e keni!

EDITA TAHIRI: Deputete Lama, përsëri nuk jeni e informuar. Me gjasë nuk po i lexoni dokumentet e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Unë kam raportuar para Komisionit për Çështje të Komuniteteve dhe të Drejtave të Njeriut, për çështjen e të pagjeturve. Faleminderit!

KRYESUESI : Zoti Beqiri, replikë me zonjën zëvendëskryeministre.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zotni nënkryetar!

Me të vërtetë është e habitshme, në vend që të raportojë, që e ka obligim, kjo na shet demagogji dhe pikërisht kërkesa dhe diskutimi i vet deputetes nga radhët e LDK-së më herët ishte kjo, që nuk po respektohet Rezoluta që është nxjerrë nga ky vend, nga ky Kuvend, për të informuar për rrjedhat e bisedimeve.

Ne marrim informacione, më së pari, fatkeqësisht është, edhe marrëveshja e fundit është publikuar në mediat serbe, pastaj e kemi parë në gazetatat tona, si Kuvend asnjëherë s'e kemi parë asnjë marrëveshje, e ashtuquajtur marrëveshje gjatë këtyre bisedimeve.

Ju me dy këmbët, e nderuara Tahiri, po e shkelni atë Rezolutë të këtij Kuvendi. Mos u merrni me LDK-n. Ne përfaqësojmë elektorat dhe ju duhet ta kryeni obligimin që e keni dhe lëreni nostalgjinë, sepse ne ju kuptojmë edhe për atë punë, por po ju kërkojmë edhe njëherë jo në pyetje parlamentare, se nuk mjafton, bëni raport, informojeni këtë Kuvend, çka po ndodh me këto negociata, në këtë shutle diplomacy tuajën personale, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj e keni obligim dhe ne nuk kemi nevojë të ju lusim për këtë, ju e keni obligim t'i raportoni këtij Kuvendi dhe qytetarëve, çfarë po ndodhë me këto bisedime, deri dje sipas jush teknike, tashmë politike, për ne kaherë politike, sepse ka qenë e ditur kjo, botërisht, prandaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkojmë ju t'i informoni sikur edhe

të tjerët, atë çka po ndodhë dhe mos u merrni me Lidhjen Demokratike të Kosovës, sepse duhet të merreni me punën, që jeni kah e bëni edhe si Qeveri, në mënyrë të përgjegjshme edhe vetë, personalisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Kundërreplikë.

EDITA TAHIRI: I nderuar, deputet Beqiri, Në qoftë se e keni parasysh, gjatë tërë procesit të dialogut teknik, Qeveria e Republikës së Kosovës, ka informuar dhe raportuar rregullisht, përfshirë edhe marrëveshjet e fundit, të cilat kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi, ka folur gjerësisht dhe me elaborim.

E dyta, sikur ju zoti Beqiri, si LDK, të jeni të interesuar për informim, nuk e shtroni çështjen e dialogut në kuadër të debateve jashtë rendit të ditës, po ju mund ta bëni siç bëri deputetja Lama, të shtroni pyetje dhe merrni përgjigje.

E treta, ne do të raportojmë në Kuvend, sa herë që do të na ftojë Kuvendi.

E katërta. Po më vjen mirë që e paske përparuar në anglisht për fjalën “shuttle diplomacy”, por mos harro diçka po të them...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: E keni përfunduar fjalën!

(Reagim)

Deputetja Teutë Haxhiu, pyetje për ministrin Ramë Buja.

(Ndërhyrje)

Jo, jo! Me Rregullore, s’ke drejtë. Unë ta jap fjalën, po Rregullorja s’ta jep! Deputetja Teutë Haxhiu, pyetje për ministrin Ramë Buja. Vazhdo!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Pyetja ime drejtuar...

(Reagime - polemikë)

Kryesues! Krijoma pak mundësinë për me vazhduar diskutimin!

Atëherë, zoti ministër! A keni bërë studim paraprak kur e keni marrë vendimin që gjuha shqipe të futet në të gjitha njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës? Nëse po, ku, kur dhe nga kush është bërë ky studim?

KRYESUESI: Ministër Buja, e keni fjalën!

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar, zoti kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Haxhiu,

Ju, e dini mirë se cila është kompetenca ligjore e ministrit për të ndërhyrë për atë që duhet ndërhyrë, nëse mund ta quajmë kështu, në Universitet dhe kjo çështje nuk ka qenë çështje e Ministrisë. Ka qenë çështje ekskluzive e Universitetit dhe me propozimin e rektorit të Universitetit Senati i Universitetit publik të Prishtinës ka marrë vendim me datën 27.09.2010 për ta futur gjuhën shqipe, si gjuhë domethënëse si lëndë të rregullt në të gjitha njësitë akademike. Dhe, ky zbatim i këtij vendimi nga Senati ka filluar të zbatohet këtë vit akademik dhe arsyetimi është për shkak të nivelit të dobët të komunikimit me shkrim të studentëve në testet provuese, në ato kolloqfime që i quajnë dhe në provimet përfundimtare, e këtë ne nuk e kemi kundërshtuar por as nuk kemi insistuar që të jetë.

Ne besoj bashkë e ndajmë një mendim se kjo është edhe mirë që është futur, por njëkohësisht na duket edhe shumë e rëndë për faktin s'ka pas nevojë të futet po të ishte niveli tjetër mësimor, shkollor, e përgatitor më i mirë për të mos u futur fare kjo aty. Por, megjithatë unë po ju them që ky vendim ka qenë ekskluzivisht i Senatit të Universitetit të Prishtinës.

KRYESUESI: Pyetje shtesë? Deputetes Haxhiu fjalën!

TEUTË HAXHIU: Faleminderit! Ministër aty po pajtohem që niveli apo cilësia në arsim nuk është në nivelin e duhur, por unë para vetes kam Plan-programin që është paraparë për disa javë të mbahet për një semestër.

Unë po i përmend vetëm në disa tema, për shkak të kohës. Dhe, shembull ta zëmë, në javën e pestë është paraparë që të shpjegohet nyja e përparme dhe e përparme, pastaj shenjat e pikësimit, gjinia e emrit, trajta, rasa, shumësi i emrave, përemrat, e disa tjera.

Dhe, unë me përgjegjësi të plotë ju them, zoti ministër që: gjatë bisedës që kam pas me shumë profesorë që ligjërojnë në shkollën e mesme të ulët, ky plan program që është paraparë këtu në këtë draft - punohet që nga klasa e pestë e deri në klasën e nëntë dhe ajo përsëritet vit pas viti.

Prandaj, them nëse për këto vite nxënësit tonë për 12 vjet kanë dalë të paaftë, unë konsideroj se këtu është një gjë që bie në kundërshtim me atë se...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Buja!

MINISTRI RAMË BUJA: E nderuar, po i nënkuptoj shqetësimet, sepse në fakt jemi bashkë në një pozicion. Nuk kemi pse t'i themi gjë njëri-tjetrit, sepse në fakt ky nivel që e kemi është ai që e kemi dhe ne po insistojmë që cilësinë ta ngrisim dhe fokusi i veçantë është cilësia në arsim në këtë mandat dhe kjo nuk do të përfundojë me këtë mandat sepse, në fakt, kemi shumë punë për të bërë.

Unë po e them pa therë në gjuhë përsëri, domethënë edhe pedagogët që janë në Universitet nganjëherë, për mos me thënë shpeshherë, kanë lajthitje gjuhësore, në të shkruar gjithsesi po e po, andaj problemi është që ne po insistojmë që në aspektin cilësor të ngritët kjo çështje.

Por ato që thoni ju se çfarë kanë bërë plan programet e kësaj lënde, ne s'kemi përgjegjësi për këtë gjë.

Përsëri është Senati i Universitetit të Prishtinës që ka marrë vendim për t'i futur këto plan programe në këtë mësim të gjuhës, në njëfarë forme mësim plotësues apo qysh mund ta quajmë për ta ngritur nivelin gjuhësor dhe komunikues të këtyre studentëve që i kemi në Universitetin publik të Prishtinës.

KRYESUESI: Faleminderit!

Mua më vjen keq që nuk u kuptuam drejt me zotin Beqiri.

Ai nuk ka drejtë në kundër-replikë tjetër. Rregullorja e jep vetëm një kundër-replikë. Rregullorja e re është në shqyrtim, mund të amandamentohet prapë.

Unë e di që nuk është e zgjedhur mirë çështja e replikës dhe kundër-replikës, sepse shkon në favor të folësit të parë sipas Rregullores aktuale, por hajde ta rregullojmë ndryshe dhe mund ta aplikojmë pastaj kundër-replikën e dyfishtë ose mund ta vendosim vetëm një replikë pa të drejtë kundër-replike, siç e kanë të tjerët.

Andaj, proceduralisht nuk ka të drejtë zoti Beqiri, i cili me të drejtë ndoshta u revoltua. Po, si kryetar grupi shoqërisht mund ta merr fjalën për pikën tjetër vijuese dhe mund të bëjë deklaratë e po ashtu t'i ndjek të gjitha procedurat e mundshme në Kuvend.

Deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri, pyetje për ministrin Ramë Buja. Nuk është këtu!

Deputetja Donika Kadaaj-Bujupi, pyetje për zëvendëskryeministren Edita Tahiri. Urdhëroni!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Po, pyetja ime është: Sa kushtoi periudha e pas fusnotës për taksapaguesit e Kosovës?

KRYESUESI: Zonja zëvendëskryeministre, urdhëroni!

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: E nderuar deputete Kadaaj-Bujupi,

Marrëveshja për përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal është arritur në Bruksel më 24 shkurt 2012 me ndërmjetësimin dhe garantimin e Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Kjo marrëveshje ka rëndësi të madhe, sepse hap mundësitë për përfaqësimin dhe anëtarësimin e shtetit të Kosovës në të gjitha organizatat dhe nismat rajonale që ekzistojnë tash dhe ato që do të krijohen në të ardhmen.

Marrëveshja në fjalë, përcakton qartë se Kosova përfaqësohet si shtet sovran dhe i pavarur, flet në emër të vet si dhe i nënshkruan marrëveshjet rajonale.

Po ashtu, kjo marrëveshje i jep fund UNMIK-ut në përfaqësimet për Kosovën, gjë që ndodh për herë të parë pas pavarësisë së Kosovës.

Me arritjen e kësaj marrëveshjeje, Qeveria e Republikës së Kosovës ka forcuar sovranitetin ndërkombëtar të shteti tonë, ka avancuar interesat nacionale, ka respektuar Rezolutën e Kuvendit të Kosovës dhe vijat e kuqe si dhe i ka siguruar vendit perspektivën e qartë evropiane dhe Euro- Atlantike.

Kosova, edhe me këtë rast, dëshmoi se i kupton mirë dhe i përmbushë me përgjegjësi obligimet Kushtetuese për integritet evropian, si dhe standardet evropiane ku fqinjësia e mirë dhe bashkëpunimi rajonal janë ndër kushtet kryesore. Si rezultat Bashkimi Evropian mori vendimin për ta nisur procesin e marrëveshjes së stabilizim-asocimit me Kosovën, pra BE-ja e njohu zyrtarisht Kosovën si shtet për anëtarësim potencial në Bashkimin Evropian.

Ashtu siç tha edhe sekretarja amerikane Klinton, Kosova duke u përfaqësuar si shtet i barabartë në nisma rajonale, ka forcuar pavarësinë e vet, ka afruar vendin me BE-në, si dhe ka rritur shtegun e njohjeve ndërkombëtare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, Deputete Kadaj?

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Me të vërtetë po më befasoni me ikjen nga përgjigja.

Unë po ju pyes për tripin e fundit 3-ditorë në Shqipëri, i cili është në kuadër të këtyre lëvizjeve të juaja pas fusnotës, që ka kushtuar 50 000 euro!

- “50.000” euro, të cilat është dashur me shkua, për shembull, në QKU ku tualetet pikojnë!

- “50.000” euro, të cilat janë marrë nga taksat e pensionistëve, mjekëve e policëve!

- “50.000” euro të cilat janë marrë nga 18%-shi i qytetarëve të Kosovës, që jetojnë në varfëri ekstreme!

Se çka po fiton Kosova nga ju, po shihet. E keni sjellë një rezolutë të vdekur 1244, e cila do të na sjell probleme edhe në të ardhmen.

Se sa po humbim në buxhetin e Kosovës, kërkoj që të na raportoni me shkrim në këtë Kuvend dhe të na bini shifra të sakta të shumave që ju po i shpenzoni duke shëtitur poshtë e lartë.

Sa i përket dëmeve që i keni bërë Kosovës, mendoj që pas kësaj fyerjeje të fundit me datën 8 mars, ju zonjë, duhet të shkoni në shtëpi edhe të mos vazhdoni t'i sillni dëme as buxhetit të varfër të Kosovës, e as...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja zëvendëskryeministre!

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Donika, në pyetjen tuaj, nëse e keni pas ndërmend me pyet për një udhëtim konkret - është dashur ta precizoni pyetjen.

Megjithatë, unë do të përgjigjem në pyetjen tuaj dhe do t'ju them se ...

(Ndërhyrje)

Po, më lejoni! Donika! Zoti kryesues nuk mund të flas!

KRYESUESI: Të keni parasysh, respektoni këtë! Kjo është duke u përgjigjur. Ju lus Donika, sepse jemi kolegë!

(Ndërhyrje)

Po mirë, mirë! Ministre, 20 sekonda i keni më shumë, dhe vazhdoni!

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Me demokraci Donika, me demokraci!

Donika! Kjo periudhë i kushtoi Serbisë me njohjen de fakto të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës.

E sa i takon vizitës në Tiranë, unë kam shkuar në vizitë zyrtare me ftesën e kryeministrit Berisha. Ndërsa udhëtimi i grave shërbyese civile të Qeverisë, ka qenë një udhëtim i veçantë. Ju faleminderit!

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Faleminderit! Shkojmë tutje: Deputetja Donikë Kadaj-Bujupi pyetje për zëvendëskryeministren Mimoza Kusari, që nuk është këtu. A dëshironi ta lexoni pyetjen, deputete? Fjalën e ka deputetja Bujupi!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Është shumë interesant! Sa herë që i bëj pyetje, nuk është këtu?!

Në vazhdimësi me pompozitet po vazhdon me thënë që masat e reciprocitetit ndërmjet Serbisë dhe Kosovës po zbatohen. Kjo nuk është e vërtetë, dhe unë do ta paraqes para juve veç një argument.

Hapësira ajrore e Kosovës shfrytëzohet nga Serbia, ndërkaq hapësira ajrore e Serbisë nuk lejohet që të shfrytëzohet nga ana e Kosovës.

Si pasojë e kësaj, qytetarët e Kosovës dhe të gjithë ata që fluturojnë prej dhe në Kosovë vazhdojnë të paguajnë bileta tepër të shtrenjta dhe vazhdojnë të kenë probleme shumë të mëdha duke pasur nevojën që t'i bien rreth e rrotull sa herë që kanë nevojë me udhëtuar prej ose në Kosovës.

Unë desha me e pyet, se: Si Qeveria Thaçi, dhe në veçanti zëvendës-kryeministrja Kusari e kupton masën e reciprocitetit? Sepse, ky është një kuptim arbitrar.

Do të thotë, në vazhdimësi, dalja në media dhe të pa vërtetat që Kosova dhe Serbia po i zbatojnë masat e reciprocitetit, ndërkaq në anën tjetër mos reagimi ndaj shkeljes së këtyre masave nga ana e Serbisë - tregon se kjo Qeveri edhe është e paaftë, edhe është e gatshme që me vazhduar me ua thanë të pavërtetën qytetarëve të saj. Dhe, thjeshtë nganjëherë po mendoj që as vet nuk e kupton, sepse ka një kuptim arbitrar për marrëdhëniet reciproke ndërmjet dy shteteve të pavarura. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Kuleta, pyetje për kryeministrin Thaçi. Nuk është këtui! Deputet, a dëshironi ta lexoni pyetjen? Zoti Kuleta e ka fjalën!

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë pata pyetje për kryeministrin Thaçi, por ai iku në momentin kur e ka obligim të qëndrojë këtu. Dhe kjo, edhe pse nuk është e habitshme për shkak të mirësjelljes, unë po dua me u habit - pse po ndodh kjo?!

Përndryshe, pyetjen do ta lë për herën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Bakalli, pyetje për ministrin Hoxhaj!
Zonja Aurora Bakalli e ka fjalën!

AURORA BAKALLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në mes datës 3 dhe 4 shkurt të vitit 2000, do të thotë, menjëherë pas luftës -në pjesën veriore të Mitrovicës ndodhi një masakër e tmerrshme mbi popullatën shqiptare atje. Pas kësaj ngjarje, pasoi dëbimi i mbi 12.000 shqiptarëve nga ato treva. Do të thotë ndodhi një spastrim etnik i përmasave të jashtëzakonshme.

Megjithatë, në vazhdimësi nga institucionet e Kosovës, kjo çështje është mbajtur e heshtur.

Pyetja ime për ministrin e Punëve të Jashtme është kjo: Pse ju zoti ministër, në paraqitjet e juaja në OKB po e heshtni spastrimin etnik të shqiptarëve të Mitrovicës në ndërkohë që

homologu juaj nga Serbia nuk pushon së përmenduri qoftë edhe duke sajuar ekscese krejt të parëndësishme që, gjoja po ndodhin kundër serbëve, në pjesë të ndryshme të Kosovës? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër Hoxhaj, e keni fjalën!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, shumë zoti nënkryetar!

I nderuar zoti zëvendëskryeministër, ministra,
Shumë të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
E nderuara deputete Bakalli,
Të faleminderit shumë për pyetjen e bërë!

Më lejoni që në 3 pika t'ysnoj të jap një përgjigje të plotë.

Së pari, dua të them se situata në veri të Kosovës dhe në qytetin e Mitrovicës ka qenë çdoherë pjesë e çdo qëndrimi, fjalimi apo edhe e prononcimit tim në Këshill të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Përveç kësaj, situata në veri të vendit, 12 vjetët e fundit, edhe vitet e fundit ka qenë dhe është pjesë e çdo takimi multilateral apo çdo takimi bilateral dypalësh në nivel rajonal, evropian dhe global, qoftë zyrtar, qoftë takim publik.

Së dyti. Kur flasim ne shpeshherë për Mitrovicën dhe veriun, e krijojmë një përshtypje ndoshta të gabuar sikurse është një rajon i madh. Këtu është fjala për 3 komuna e gjysmë dhe në çdo fjalim që unë e kam mbajtur në Këshill të Sigurimit, më datën 12 maj 2011, më datën 30 gusht 2011, më datën 15 shtator 2011 dhe me datën 29 nëntor 2011 gjysma e fjalimit tim i referohet situatës në veri të vendit.

Këto fjalime janë publike. Mund të gjinden në internet dhe mund t'i shihni edhe qëndrimet e mia në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Unë kam qenë shumë i qartë dhe kam thënë se është e vetmja pjesë e Kosovës që nuk ka zgjedhje të lira. Është e vetmja pjesë e Kosovës që nuk ka pjesëmarrje demokratike dhe është e vetmja pjesë e Kosovës dhe i vetmi kënd në Evropë në të cilin nuk ka sundim të ligjit.

Po ashtu, në mënyrë të detalshme, i kam informuar çdoherë anëtarët e Këshillit të Sigurimit se këto struktura në veri të Kosovës udhëhiqen, kontrollohen, financohen direkt nga Beogradi dhe Beogradi është përgjegjës për gjendjen në veri.

Së treti, më lejoni të them se në fjalimin e fundit tim me 8 shkurt të 2012-ës, paragrafi 2 i fjalimit tim, që është në gjuhën angleze, flet pikërisht për politikën e spastrimit etnik në Kosovë. Flas për atë se si një milion qytetarë, si qëllim i kësaj politike të spastrimit etnik, janë dëbuar nga Kosova, flas për dhunën dhe terrorin serb në mes të vitit 1990 deri në vitin 1999. Mendoj se ky fjalim është publik dhe mund të shihni që e kam ngritur një çështje të tillë.

Kuptohet se të tjerët bëjnë përpjekje që për Kosovën të ofrohet një fotografi jo e saktë, jo objektive dhe një fotografi i një vendi jonormal dhe shumica e prononcimeve që vijnë nga të tjerët - që janë armiq të shtetit dhe shtetësisë së Kosovës, synojnë mbi të gjitha që ta krijojnë pikturën apo...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Urdhëroni për pyetje shtesë, deputete Bakalli!

AURORA BAKALLI: Zoti ministër, Mendoj se përgjigja juaj nuk ishte konkrete. Mua më intereson pikërisht se sa keni folur për dëbimin e shqiptarëve nga pjesa veriore e Mitrovicës?

Më intereson për spastrimin etnik pas vitit 2000 që ka ndodh në Mitrovicën e veriut?

Këto çështje, mendoj se nëse i prekni në skenën ndërkombëtare, shumë më fuqishëm, i trajtoni më me këmbëngulje dhe në vazhdimësi - do të japin pasqyrë krejt tjetër për strukturën në pjesën e veriut të Mitrovicës dhe të veriut në përgjithësi.

Ndërkaq, mendoj se është obligim i juaji dhe i gjithë Qeverisë që të bëni përpjeke për kthimin e këtyre shqiptarëve në pronat dhe shtëpitë e tyre. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër e keni fjalën!

MINSITRI ENVER HOXHAI: Më lejoni, të them që çdo qëndrim i yni në Këshillin e Sigurimit e reflekton gjendjen në një periudhe të caktuar kohore. Dhe, unë si ministër i Punëve të Jashtme të Kosovës, duhet të marr qëndrim për të gjitha çështjet që janë aktuale të rëndësishme në takime të tilla të Këshillit të Sigurimit.

Ju thash se në çdo takim që deri më tash kam marr pjesë, pra në gjashtë takime, situata në veri të vendit edhe situata e spastrimit etnik atje - ka qenë pjesë e fjalimeve të mija dhe çdoherë nuk flas vetëm për atë se çfarë ndodh në tre muajt e fundit por flas për periudhën 10 vjeçare a 20 vjeçare, duke e përfshirë edhe periudhën kohore të cilën ju e keni në fjalë.

Së dyti, dua t'ju informoj dhe mund t'ju dërgoj edhe juve për informatë se Ministria e Punëve të Jashtme çdoherë harton letra, koncepte dhe raporte të detajshme që iu dërgohen të gjitha shteteve që ekzistojnë në botë, atyre që e kanë njohur Kosovën dhe ato që nuk e kanë njohur Kosovën për tema të ndryshme. Letra të tilla ne iu kemi dërguar edhe vitin e kaluar disa shteteve, sidomos pas 25 korrikut të vitit 2011.

Edhe këto dy ditët e fundit, i kemi dërguar disa shkresa në disa vende që kanë të bëjnë me gjendjen në veri të vendit dhe kuptohet se, spastrimi i qytetarëve shqiptarë në atë pjesë të Kosovës, është pjesë e një dokumentacioni të tillë.

KRYESUESI: Faleminderit! Është vetëm edhe një pyetje e deputetes Kimete Bytyqi, për zëvendëskryeministrin Kuçi. A është këtu deputetja?

(Ndërhyrje)

Po, po që tash! Në rregull, në rregull! Deputetja Bytyqi e ka fjalën. Është pyetje për zëvendëskryemministritin Kuçi!

KIMETE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Pyetje për ministritin Kuçi. Duke ditur mandatin e Ministrisë, të cilën e drejtoni ju, kërkoj nga ju, zoti ministër të më përgjigjeni në pyetjen si në vijim: Sa është numri i të punësuarve nga gjinia femërore në Shërbimin Korrektues të Republikës së Kosovës dhe në këtë kuptim, a është arritur kriteri i barazisë gjinore të përcaktuar me Ligjin për barazi gjinore?

KRYESUESI: Zoti zëvendëskryeministër, e keni fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit! I nderuari nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

E nderuara deputete Bytyqi,

Ministria e Drejtësisë në vazhdimësi i ka kushtuar një kujdes të veçantë kriterit për barazi gjinore në rastin e pranimin të zyrtarëve në gjitha departamentet dhe institucionet relevante të drejtësisë në Kosovë.

Në veçanti i kemi kushtuar kujdes edhe Shërbimit Korrektues të Kosovës, me theks të veçantë, Qendrës Korrektuese të Lipjanit, ku janë të vendosura të burgosurat femra.

Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve 1.605, të gjinisë femërore janë 259 apo 16.14%, kurse në Qendrën Korrektuese në Lipjan, në pavijonin e femrave i tërë stafi është i gjinisë femërore, ku janë gjithsej 55 të punësuar.

Në të gjitha institucionet korrektuese kemi punësuar oficerë me uniformë, por jo në numrin e dëshirueshëm edhe përkundër përpjekjeve tona dhe shpalljes së përhershme të konkurseve.

Për shkak të natyrës së punës, në institucionet korrektuese, me përjashtim të asaj në Lipjan, nuk paraqiten në konkurs femra në numër të konsiderueshëm.

Vlen të theksohet po ashtu se numri i të punësuarve shpesh ndodh që ta lëshojnë punën, pasi që nuk është lehtë të punohet në kontakt të drejtpërdrejtë me të burgosur.

Unë dhe Ministria e Drejtësisë në të ardhmen do të kujdesemi dhe do t'i inkurajojmë femrat apo personat e gjinisë femërore që të aplikojnë me rastin e shpalljes së konkurseve dhe në këtë drejtim do t'i respektojmë ligjet në fuqi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Fjalën, deputetes Bytyqi!

KIMETE BYTYQI: Faleminderit, ministër!

Atëherë, zoti ministër gjatë mandatit tuaj, cili do të jetë angazhimi juaj gjatë atij mandatit që ta ngrisni përqindjen në 40%?

KRYESUESI: Zëvendëskryeministër!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI : Faleminderit! Unë nuk premtoj se mund ta rris një përqindje të tillë dhe janë dy arsye.

Arsyeja e parë është se unë kam trashëguar një numër të madh të gardianëve në Kosovë, përkundër asaj që ka pasur edhe kritika publike dhe unë do të them se nga koha që jam emëruar ministër nuk është zgjedhur asnjë gardian, se unë konsideroj që duhet të jetë proporcioni 1 me 2 ose 1 me 3, sikur që është në Perëndim, dhe jo sikur është tani. Gati numri ka qenë i përafërt sa ka gardianë dhe sa ka të burgosur. Po unë jam i bindur se në konkurset e ardhshëm do ta kenë trajtimin e veçantë dhe në kushte të barabarta gjithmonë do të kenë përparësi gjinia femërore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-ës, zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zotni nënkryetar!

Unë në emër të Grupit kërkoj në pauzë 15-minutëshe, sepse na duhen disa konsultime pas asaj që ndodhi kur unë në emër të Grupit Parlamentar kam kërkuar fjalën, bazuar në nenin 40, prandaj lidhur me këtë e kërkoj një pauzë 15-minutëshe.

KRYESUESI: Edhe një herë, sqarim shtesë të jap. Nuk e keni kërkuar fjalën në emër të kryetarit të Grupit Parlamentar. Ju keni qenë në një replikë e kundër-replikë, dhe unë nuk kam dashur me ta dhënë dy herë fjalën, për kundër-replikë.

(Ndërhyrje)

Kur të duash, e ke fjalën, i ke edhe ato 15 minuta pushim. Po, 15 minuta pushim do t'i keni, por mos thuaj se ke kërkuar fjalë në emër të Grupit Parlamentar sepse s'e ke kërkuar.

(Ndërhyrje)

Ti ke qenë në replikë, dhe e ke kërkuar fjalën për replikë me Edita Tahirin.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

(pas pauze, seanca vazhdoi punën)

KRYESUESI, XHAVIT HALITI: Po vazhdojmë punën. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka kërkuar Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zotni nënkryetar!

Kjo që ndodhi para pauze, është një skandal i llojit të vet, të cilin e bëri zonja me anglishten e fortë të saj e me veprimet antishtetërore.

Është një fyerje ndaj Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës sepse këtu s'kishte asgjë personale dhe unë kam kërkuar fjalën në emër të Grupit Parlamentar, në kohën kur fare Grupi Parlamentar nuk i është adresuar dhe kjo e ka etiketuar, e ka fyer një elektorat, një trup të madh elektorat. I ka fyer 27 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës që e përfaqësojnë atë trup elektorat dhe dikush që as votat e katundit të vet nuk i merr, e u ardhur me kombinatorika të ndryshme, është problem i saj.

Ne, zoti nënkryetar, kërkojmë që të respektohet deputeti, të respektohen deputetët këtu që janë, në këtë rast nga Qeveria ose pjesëtarët e Qeverisë me sjellje të paedukatë sepse dhjetë herë nëse dikush përmendet në Kuvend prej Qeverisë ose ministrit, po aq ka të drejtë edhe t'i kundërshtojë.

Edhe një herë e them, me përgjegjësinë më të madhe, se kjo sot e ka bërë një veprim të llojit që e di vetëm zonja Tahiri. Dhe ne jemi të lumtur si Grup Parlamentar që as anglisht e as shqip nuk bëjmë veprime siç i bën kjo kundër vendit dhe kjo do t'ua shpjegojë edhe "fluskat e dëborës" që s'i ka ditur, e është problem i saj.

Por, ju lus zotni nënkryetar – mos lejonit të fyhemi si deputetë, si Grup Parlamentar në këtë rast, nga dikush të cilëve ne në këtë rast edhe një edhe dhjetë nëse janë, frustrimet personale e individuale nuk është vendi këtu që tua zgjedhë në këtë rast as grupi parlamentar as ky Kuvend. Ato është mirë me i mbajt për veti dhe në shtëpitë e tyre.

Andaj, ju lus që në të ardhmen, kur kërkohet fjala në emrin e Grupit Parlamentar, dhe po ua përsëris, nëse dikush s'e paska marrë vesh: Unë e kryesoi Grupin Parlamentar dhe kam të drejtë të replikoj kur fyhet deputeti gjegjësisht Grupi Parlamentar dhe subjekti serioz opozitar, siç është në këtë rast Lidhja Demokratike e Kosovës.

Kjo duhet t'i kërkoj falje edhe Grupit Parlamentar, edhe deputetëve për sjelljet e saja karshi nesh, pa asnjë arsye dhe pa asnjë të vetmin pretext.

Justifikimet për veprimet e saj, gjykimin për veprimet e saj ka me e dhënë koha dhe ne nuk jemi ata, e ne nuk dëshirojmë të bëhemi gjykatës, por nëse mendon zonja Tahiri se ne i bëjmë amin veprimeve të saj të papërgjegjshme, këtë le ta harrojë sepse qytetarët tanë – dhe vota nuk na lejon të bëjmë gjëra ose të bëjmë miratim për atë që e bën kjo zonjë, e nderuar, e Qeverisë së Kosovës.

Prandaj, edhe një herë, në fund, zotni nënkryetar, po ju lus ua ndërpreni njerëzit e frustruar që sulmojnë në këtë rast një grup, një trup të madh elektorat, siç është LDK-ëja.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Beqiri!

Unë jam i obliguar prapë ta lejoj replikën, dhe keni të drejtë edhe ju në kundër-replikë, siç e pati kjo më herët.

Unë, jam i bindur se e kam respektuar Rregulloren dhe asgjë nuk kam pas me qëllim të keq, as ndaj zonjës, as ndaj jush. Fjalën e keni, zonja Tahiri për replikë. I keni dy minuta, këtë e dini!

EDITA TAHIRI: I nderuar udhëheqës i Grupit Parlamentar të LDK-ës, Unë i qëndroj parimit se funksionimi këtu në Parlament duhet të ndjek rrugën institucionale, andaj edhe thashë – për të marrë informacione duhet të ndiqet rruga institucionale dhe jo të shtrohen çështjet në kuadër të pikës, pra të çështjeve jashtë rendit të ditës.

Prandaj, sa herë që do të kërkohet informacion dhe raportim nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e unë po ashtu ju konfirmova se kryeministri i Republikës së Kosovës zoti Thaçi ka dhënë elaborime të hollësishme për marrëveshjet e arritura në Bruksel. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Beqiri!

ISMET BEQIRI: Zonja Tahiri,
Me të vërtetë jeni kah i ngatërroi gjërat.

Unë fola dhe ju replikova për fyerjet që ia bëni Grupit Parlamentar të LDK-ës. Kurse për vlerësimet tuaja, edhe për individ edhe për deputetë, ju e keni obligim me e respektuar Rezolutën e këtij Kuvendi për ta informuar këtë Kuvend dhe tash mos e ngatërroi kryeministrin. Ne, këtë punë e kemi me ju, në kuptimin e sqarimeve dhe informatave.

Pra, ju e keni obligim me i dhënë informatat dhe ju nuk i keni dhënë informatat se çfarë po ndodhë. Prandaj, mos na tregoni ku është sporteli që ne të shkojmë t'i marrim informatat. Ju e keni obligim me i raportuar Kuvendit konform Rezolutës së këtij Kuvendi.

Mos bëni demagogji, sepse kjo është demagogji shumë e pastër e juaja dhe vërtet është “fluskë që shkrihet” menjëherë tash, edhe pa qenë vera, sikundër që nuk do të shkrihet edhe verës ajo çka i keni bërë Kosovës me atë “fluskë”...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas Rregullores, nuk keni të drejtë me zgjatë më shumë diskutimin. Për këtë më falni!

Pra, para se të shkojmë te pika e tretë e rendit të ditës, ne e kemi një çështje për ta shqyrtuar që ka të bëjë me një marrëveshje që është bërë në mes grupeve parlamentare për ta miratuar sot një rezolutë dhe lidhur me këtë fjalën e ka kërkuar zoti Grabovci për ta sqaruar kërkesën dhe mendoj e shpresoj se do ta votojmë të gjithë. Faleminderit!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Ministra,

Kolegë të nderuar,

Pas vendimit të Kuvendit të Serbisë për shpalljen e zgjedhjeve në territorin e Kosovës, liderët politikë janë takuar dhe kanë nxjerrë një deklaratë të përbashkët, nënshkrimet e të gjithë liderëve janë këtu dhe pas kësaj deklarate, në konsultim me shefat e grupeve parlamentare, propozojmë që Kuvendi i Kosovës ta nxjerrë një rezolutë.

Të nënshkruar janë: Hashim Thaçi, Isa Mustafa, Blerim Shala, Behxhet Pacolli, Sllobodan Petroviq dhe Mahir Yagcillar.

Po e paraqes Projekt-rezolutën, për të cilën janë pajtuar shefat e grupeve parlamentare që në emër të gjitha grupeve parlamentare t'ia paraqesin Kuvendit, dhe të njëjtën ta votojnë.

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në mbështetje të nenit 65 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Duke ritheksuar se Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik dhe shoqëri multietnike, me parime evropiane,

Duke theksuar zotimin tonë në mbrojtje të sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës,

Duke riafirmuar përkushtimin e Republikës së Kosovës për të ardhmen e saj euro-atlantike dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore,

Duke ritheksuar zotimin e Republikës së Kosovës për mbrojtjen e të drejtave të gjithë qytetarëve të saj – përfshirë edhe të drejtat e komuniteteve dhe të drejtën e dyshtetësisë,

Duke marrë në konsideratë që të gjithë ata që kanë dyshtetësi në vendet evropiane, kanë të drejtë të votojnë në zgjedhjet parlamentare, të cilat mbahen në shtetet në të cilat ata kanë shtetësinë përkatëse,

I propozojmë Kuvendit për miratim këtë

R E Z O L U T Ë

1. Theksojmë se do të ishte shkelje e sovranitetit dhe cenim i marrëdhënieve fqinjësore që të organizohen në mënyrë të njëanshme zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale në një shtet tjetër evropian;

2. Konkludojmë se Republika e Kosovës, nuk do të lejojë asnjë shtet tjetër fqinj apo të ashtuquajturit përfaqësues të tij që të organizojnë zgjedhje të çfarëdo lloji në territorin e Republikës së Kosovës;

3. Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës njëzëshëm theksojmë se qytetarët e Republikës së Kosovës janë të bashkuar kundër mbajtjes së çfarëdo procesi zgjedhor, i cili do të minonte sovranitetin shtetëror të Kosovës, do të cenonte shtetësinë e saj, do të cenonte integritetin territorial të saj dhe rrjedhimisht do të minonte procesin e pajtimit ndëretnik në Kosovë; dhe

4. Kuvendi i Republikës së Kosovës, konfirmon se të gjitha subjektet politike, qofshin ato në pozitë apo opozitë, do të punojnë në përputhje me parimet evropiane, me të drejtën ndërkombëtare dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Prandaj, ju bëj thirrje të gjithëve që ta votojmë këtë rezolutë të paraqitur nga të gjitha grupet parlamentare të Kuvendit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë, pas propozimit jam i obliguar, meqë është e nënshkruar nga kryetarët e grupeve parlamentare që ta vë në votim për ta renditur në seancë si pikë të rendit të ditës.

(Ndërhyrje)

Për debat, e dini Rregulloren! Askush s'mund ta ndalojë debatin për asnjë çështje në Kuvendin e Kosovës. Zoti, Hamiti a e doni fjalën tash, apo pasi ta qesim në votim.

(Ndërhyrje)

Po, por a do ta marrësh fjalën para se ta fusim në rend dite?

(Ndërhyrje)

E kam fjalën vetëm për këtë kërkesë, e për rend të ditës pastaj. A e doni fjalën tash? OK!

Atëherë, pika e parë, tani sipas radhës, ose pika e katërt dhe tjerat shtyhen, është propozuar që të jetë propozimi për një rezolutë.

Prandaj, e vë në votimin formal këtë propozim.

Kush është për? Shumica!

Kundër? Nuk ka.

Në sallë, për momentin janë të pranishëm 75 deputetë në seancë.

Konstatohet se me shumicë absolute votash, pa asnjë kundër e asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi propozimin që të miratojmë rezolutën e propozuar nga kryetarët e grupeve parlamentare.

Tani do të futemi në procesin e rregullt të punës së seancës. Pika e radhës është pika e tretë, si vazhdimësi e kësaj.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

A ka kush vërejtje lidhur me Procesverbalin?

(Ndërhyrje)

Po, po! Urdhëroni! Zoti Hamiti e ka fjalën, lidhur me Procesverbalin!

SABRI HAMITI: Mendoj që është momenti këtu në seancë të thuhet, se disa formulime që janë në procesverbal, e që janë pak si klishe atje, duhet të ndërrohen dhe nëse pika është e debatit të thuhet: në debat morën pjesë edhe këta: dhe jepen emrat e deputetëve.

Atje thotë: kanë bërë vërejtje, kanë shprehur opinione! Deputetët nuk bëjnë vërejtje dhe nuk shprehin opinione, se s'janë qytetarë të zakonshëm, por janë njerëz të zgjedhur që bëjnë propozime, japin alternativa dhe më në fund votojnë për dhe kundër për diçka.

Pra, po rezymo. Herëve tjera, kur është pika e debatit të thuhet: Në debat morën pjesë ose debatuan, e jo ato tri shprehjet që e relativizojnë çdo gjë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Jam dakord për këtë edhe unë, dhe s' besoj se ka ndokush kundër.

Atëherë, me vërejtjet e zotit Hamiti, konstatohet se Kuvendi i miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura me 1, 2 e 9 mars 2012.

Sipas Rregullores apo sipas vendimit që morëm, radha është për ta miratuar propozimin e rezolutës.

Propozuesi e pati fjalën në emër të kryetarëve të grupeve parlamentare. Mendoj se grupet parlamentare kanë të drejtë të shprehen prapë në emër të grupeve dhe mund të diskutojnë.

Tani, sipas Rregullores apo sipas vendimit që morëm, radha është për pikën e katërt:

4. Shqyrtimi i Propozim-rezolutës kundër zgjedhjeve të Serbisë në veri të Kosovës

Fjalën e ka kërkuar deputeti dhe nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti

SABRI HAMITI: Zotni nënkryetar i Kuvendit, Haliti,
Zotni kryeministër, Hashim Thaçi,
Zëvendëskryeministra dhe ministra,
Kolegë të nderuar deputetë,

Do të përpiqem të flas sa më shkurt. E konsideroj se është e nevojshme që Kuvendi të marrë një vendim rreth problemit të deklaruar se Serbia do të mbajë zgjedhje në Kosovë.

Unë kam dëgjuar, edhe para kësaj sot, prononcimet e Qeverisë, e kam dëgjuar prononcimin e kryeministrit. Një formulim, unë mendoj shumë i saktë dhe i ashpër në të folur, por i saktë. E kam dëgjuar edhe variantin e zëvendëskryeministrit Kuçi, i cili e lakon gjuhën në mënyrë figurative dukagjinçe dhe thotë: “s’do të rrimë duarkryq”.

Do të vazhdoja me këtë interpretim dhe do të thoja që nëse s’janë duart kryq, i bie – s’bën kurrgjë. Atëherë, munden me qenë duart e shtrënguara, që i bie – gatitu, ose duar të ngritura lartë që i bie – dorëzohem.

Unë po pushoj këtu me këtë tip interpretimi. Megjithatë, po kthehem te tema dhe them. Nuk jam për fjalë të forta e punë të buta. Më mirë është fjalët e buta e qëndrimi më i fortë.

Sido që të jetë, kur e ndërtojmë një tekst, të cilin ne e kemi përpara, unë mendoj se duhet të dihet të theksohet saktë për çka është problemi.

Ne i kemi katër pika të kësaj rezolute në të cilat kurrkund apo gjithmonë rreth e rreth, por kurrkund nuk thuhet çka është problemi.

Shkurt, kërkoj që tri pikat e para, e treta dhe e katërta mund të mbeten si kjo, por e dyta duhet të qartësohet dhe të thuhet: konkludojmë ose rekomandojmë, ose vendosim, si të doni, se:

“Kuvendi i Kosovës nuk do të lejojë zgjedhje të Serbisë në Kosovë dhe i obligon institucionet që ta zbatojnë këtë vendim”. Pikë!

Kjo, është esenca. Dhe, kjo duhet të thuhet në këtë rezolutë.

Përndryshe, nuk ka kuptim mendoj unë, që të themi “nuk lejojmë asnjë shtet fqinj që të mbajë zgjedhje”, e tjera, e tjera se unë sa di s’ka lyp zgjedhje as Shqipëria, as Mali i Zi, as Maqedonia me i mbajt në Kosovë.

Dhe, është normale të jetë ky formulim i saktë e i qartë. Pra, ky është propozimi im. Faleminderit shumë që më dëgjuat!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kuçi, e ka kërkuar fjalën, për replikë!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

Profesor Sabriu, masi hyri në këtë logjikën e Dukagjinit... Ju jeni dhëndër i Dukagjinit, por s't'i kanë treguar krejt. Dhe, kur nuk rri duarkryq nënkupton ose e mbron veten ose i sjell dikujt. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYESUESI: Zoti Hamiti, e ka fjalën!

SABRI HAMITI: Nejse! Po, edhe kjo është dukagjinçe me familje me i shpjeguar problemet e mëdha, po unë s'do t'i shpjegoj. Por po e pranoj meqë është alternativë. Se tha, ose - ose. Domethënë variantet janë prej – deri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar zoti Visar Ymeri, kryetar i Grupit Parlamentar!

VISAR YMERY: Ju faleminderit, kryesues!

Meqenëse po e diskutojmë tekstin e Rezolutës, të paraqitur tash nga grupet parlamentare, desha vetëm me e bë një qartësim të shkurtër këtu se u përvodh, pra as nuk është rezolutë me të cilën janë pajtuar të gjitha grupet parlamentare, e as të gjithë liderët e forcave politike në Kosovë.

Pra Lëvizja Vetëvendosje as në rastin e parë, as në rastin e dytë nuk është ftuar fare për të diskutuar këto çështje, dhe është e çuditshme pse nuk jemi ftuar.

Por, megjithatë po shihet edhe këtu nga nënshkrimet në fund që janë dhënë që emri im mungon e as nuk ka hapësirë madje të zbrazët për nënshkrimin tim, e as nuk ka nënshkrim timin.

Pra është e sinqertë, kisha me ju thënë, dhe do të kishte me qenë e drejtë që ta tregoni saktë se nuk e keni ftuar Lëvizjen Vetëvendosje dhe të thoni që kjo është prej grupeve tjera parlamentare përveç Lëvizjes Vetëvendosje.

Sa i përket tekstit të Rezolutës, kisha me i shtua tri gjëra shpejt e shpejt edhe pse unë mendoj dhe e bëj me kërkesë në emër të Grupit Parlamentar që para se të vjen deri te votimi i kësaj Rezolute ta kemi edhe një pauzë në mënyrë që të konsultohemi edhe për tekstin që sa po e morëm. Do me thënë, në kohën derisa shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike e lexonte tekstin aty, neve na erdh teksti i Rezolutës. Nuk e kemi parë më parë dhe rrjedhimisht mendoj që është absolutisht e padrejtë që të kërkohet nga deputetët të votohet diçka apo një tekst i rezolutës i cili i është vendosur 30 sekonda përpara në tavolinë.

Por megjithatë, me këtë tekst që e kemi këtu, konsideroj që edhe ne preambulë po edhe në pikat e tekstit të Rezolutës, ka disa probleme.

Përveç problemit që e përmendi zoti Sabri Hamiti, që është shumë me vend, pra një problem i tekstit të Rezolutës i cili i bie, të them, rreth e rreth por nuk e godet

problemin, është edhe te preambula në pikën e katërt të preambulës, që thotë: Duke ritheksuar zotimin e Republikës së Kosovës për mbrojtjen e të drejtave të gjithë qytetarëve të saj, duke përfshirë edhe të drejtat e komunitetit dhe të drejtat e dyshtetësisë.

Këtu në njëfarë mënyre pranohen që Serbia megjithatë ka të drejtë me i mbajtur zgjedhjet parlamentare në Kosovë. Pra po pranohet një pjesë e zgjedhjeve parlamentare këtu, duke pretenduar se do t'i dënojmë ato të tjerat dhe nuk do t'i lejojmë.

Por gjëja më e rëndësishme që i mungon kësaj rezolute, e që mendoj se domosdoshmërisht duhet të përfshihet në këtë tekst të rezolutës, është kërkesa e qartë ndaj Qeverisë së Kosovës për t'i marrë masat për ta parandaluar mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë.

Do me thënë, ne e kemi parë historikun prej vitit 1999 e tutje se si kanë vepruar qeveritë e Kosovës, e veçanërisht kjo Qeveri. Kemi pasur dënime goxha të ashpra verbale ndaj sado tendence të Serbisë për ta dhunuar sovranitetin e Kosovës dhe pastaj, natyrisht, që kemi pasur zmbropsje të Qeverisë nga fjalët e veta dhe lejim i Serbisë që të bëjë ajo çfarëdo në territorin e Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht, kjo Rezolutë pa një kërkesë të tillë e cila e obligon Qeverinë e Kosovës të ndërmarrë masa për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe sovranitetit të Kosovës, mendojmë se është rezolutë e pakuptimtë për shkak se është rezolutë e cila nuk i drejtohet askujt. Në fakt kjo është vetëm rezolutë të cilën do ta hedhim në ajër vetëm sa për të thënë që Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi një rezolutë dhe e cila nuk do të gjejë zbatueshmëri edhe nuk do të ketë mekanizma të zbatimit të saj.

Prandaj ne mendojmë se zgjedhjet e Serbisë në Kosovë, siç e thamë edhe në deklarinimin gjatë analizës, duhet doemos që të ndalohen dhe këtë ndalesë duhet ta bëjë Qeveria e Kosovës.

Pra, ne nuk mundemi të kërkojmë nga Serbia që ajo të heqë dorë, për shkak se ajo nuk do të heqë dorë dhe ne e dimë atë, prandaj ne duhet ta detyrojmë atë që të heqë dorë. Dhe, për sa i përket territorit të Republikës së Kosovës, Qeveria e Kosovës duhet të parandalojë edhe të mos lejojë mbajtjen e zgjedhjeve lokale të Serbisë këtu.

Përndryshe, çfarëdo fjalë që ne i themi nuk do ta trembin Serbinë po qe se nuk marrim masa konkrete. Dhe kjo rezolutë nuk ftohet për kurrfarë mase konkrete nga Qeveria, gjë që ne mendojmë se është e domosdoshme të bëhet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Donika Kada Bujupi! Donika, e ke kërkuar fjalën apo e ke shtypur gabimisht? Atëherë, OK! Fjalën e ka zoti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Duke e mbështetur nevojën e nxjerrjes së një dokumenti lidhur me situatën e krijuar, Grupi ynë Parlamentar, po ashtu mendon se ne duhet të jemi më specifikë në konkluzat dhe pika 2 do të duhej të ishte:

“Kuvendi i Republikës së Kosovës e kundërshton mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë dhe kërkon nga Qeveria dhe organet tjera përgjegjëse që të ndërmarrin të gjitha masat ligjore dhe diplomatike dhe të parandalojnë mbajtjen e këtyre zgjedhjeve në Kosovë”. Ky është mendimi ynë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Halit Krasniqi, e ka fjalën!

HALIT KRASNIQI: Ju faleminderit, nënkryetar!

Rezoluta dhe teksti i saj. Mendoj se është koha të reflektojmë të gjithë si qytetarë dhe sidomos si të zgjedhur të qytetarëve, që po kultivojmë një gjuhë dhe një sjellje të dinjitetshme në çdo veprim, dhe më tepër për këtë sjellje na obligon qasja dhe trajtimi që i bëhet Kosovës nga qendrat Euro-atlantike, me të cilat Beogradi zyrtar është shumë i interesuar të na konfrontojë dhe në këtë strategji ka investuar e po investon dhe po mobilizon shumë njerëz për ta rrënuar të ardhmen e këtij vend dhe me demagogji e perfiditet, sa edhe njerëzit me përgatitje shkollore dhe integritet intelektual i vë në dilemë.

Mendoj se pas kësaj deklarate të përbashkët nga subjektet politike të nënshkuara do të krijohet një besim që bashkërisht do t'i përgjigjemi sfidave politike në këtë vend.

Nëse ndodhë e kundërta, në çdo subjekt do të ketë tërmete në këtë vend do të ketë trandje të mëdha.

KRYESUESI : Ju faleminderit! Deputetja Lama e ka fjalën!

ALMA LAMA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Pasi na u dorëzua tani ky tekst i Rezolutës, e kuptuam se nuk paska qenë çështja e prishjes së teknikës së Parlamentit arsyeja që seanca filloi me vonesë, por çështja e mbledhjes së këtyre kryetarëve të grupeve parlamentare për të hartuar tekstin.

Mirëpo, fakti që Lëvizja Vetëvendosje nuk u ftua, flet për një veprim krejtësisht të pakuptimtë dhe dua të kujtoj të gjithë ata që e bënë këtë veprim, se diferencimi i individit apo i grupeve të cilët mendojnë ndryshe, është karakteristikë e sistemeve totalitare. Dhe, ky është një veprim me mentalitet totalitar.

Ky veprim është bërë në mënyrë të qëllimshme, sepse të gjithë e dimë këtu që Lëvizja Vetëvendosje jo vetëm sot, por gjithmonë ka qenë kundër mbajtjes së zgjedhjeve të Serbisë.

Çështja tjetër është se ne këtu po miratojmë rezoluta. Mirëpo Parlamenti e ka futur veten në një sistem vetëm deklarativ, gjë që e bënë edhe Qeveria. Pra, ka mbetur vetëm deklarative kur është fjala për çështje të tilla të rëndësisë shtetërore. E harron funksionin e saj ekzekutiv dhe kjo harresë ka ngjatur edhe në këtë deklaratë.

Mirëpo, nuk është e rastit kur kemi të bëjmë me tender publik. Atëherë Qeveria ndihet shumë më komode ose e përkushtuar ta luajë rolin e saj ekzekutiv.

Thjeshtë i bëj thirrje Kuvendit që të marrë rolin që i takon edhe në këtë proces. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Vjosa Osmani, e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Ju faleminderit, kryesues!

Për hir të qartësimit të tekstit, do të ndalem vetëm te paragrafi numër 1 ku thotë: “theksojmë se do të ishte shkelje e sovranitetit” dhe pastaj thotë: “që të organizojë në mënyrë të njëanshme zgjedhjet” pa e përmendur kush. Do të thotë është e njëjta vërejtje me atë që u përmend nga deputeti zotni Hamiti.

Prandaj, propozimi im është që thjeshtë të thuhet se: “Vendimi i Kuvendit të Republikës së Serbisë dhe mbajtja e zgjedhjeve të Serbisë në territorin e Kosovës është shkelje e sovranitetit dhe cenim i marrëdhënieve të mira fqinjësore”, sepse vendimi tashmë është marrë dhe ai vendim është shkelje e sovranitetit. Nuk mund të flasim për kohën e ardhme, “theksojmë se do të ishte”, apo thjeshtë të themi “që të organizojë zgjedhjet”, pa e përmendur kush, por të jemi më të qartë.

Është kuptimi i njëjtë, thjeshtë të qartësohet gjuha. Do të thotë:

“Vendimi i Kuvendit të Serbisë për mbajtje të zgjedhjeve dhe mbajtja e zgjedhjeve janë shkelje e sovranitetit dhe cenim i marrëdhënieve të mira fqinjësore.”.

Pra të flasim në kohën e tanishme dhe jo për të ardhmen, sepse vendimi tashmë është marrë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Kuleta, e ka fjalën.

AGIM KULETA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë e mora fjalën për të bërë një vërejtje në aspektin procedural. Nuk do të ishte kaq dramatike situata sikur të mos reflektoheshin pastaj edhe në politikë këto sjellje dhe këto gabime procedurale.

Zakonisht është bërë shprehi që rezolutat të vijnë në momentet e fundit apo edhe të ndryshohet rrënjësisht në momente të fundit rezoluta dhe pastaj reflektimet në realitet po janë shumë të mëdha.

Nuk është se Qeveria e Serbisë apo Kuvendi i Serbisë e ka marrë një vendim për mbajtjen e zgjedhjeve para dite ose në orën 12, kjo është çështje e më hershme, prandaj konsideroj që si deputet po edhe si parti në përgjithësi politike opozitare, është dashur të konsultohemi më herët dhe madje edhe të participojmë në hartimin e këtyre rezolutave dhe mocioneve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Atëherë po e zgjedhim një kompromis.

Tani po shkojmë në pauzë të drekës. Votimi do të bëhet në ora 15,00.

Tash le të jetë takimi i kryetarëve të grupeve parlamentare dhe i atyre që dhanë vërejtje për ta harmonizuar tekstin, në qoftë se ka nevojë prapë, në ora 14,30, në sallën 303. Ju faleminderit!

Kurse ne, në ora 15,30, do të vazhdojmë punën!

* * *

(Vijoi pauza dhe pas pauze, seanca vazhdoi punën)

KRYESUESI, XHAVIT HALITI: Atëherë, deri sa të vjen teksti i harmonizuar, ne po vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, që sipas rendit paraprak të ditës ka qenë pika e katërt e realisht tash është pikë e pestë e rendit të ditës: - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për komunikimet elektronike.

Në sallë, mendoj se kemi mjaft të pranishëm. Për çka e kërkon fjalën?

(Ndërhyrje)

Për rend të ditës? Atëherë, kush e do fjalën? Urdhëroni zoti Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, propozojmë që pika e tetë të hiqet nga rendi i ditës, që bëhet fjalë për Ligjin për transmetimin publik në Kosovë. Të them se amendamenti 16 i ligjit të propozuar nuk ka kaluar nëpër Komisionin për legjislacion, prandaj konsideroj po ashtu se ky nen – amendament ka probleme, ka probleme në kuptimin e draftimit të tij dhe krijon divergjencë në mes të kanalit shqip dhe kanalit që pritet të themelohet në gjuhën serbe.

Zgjedhja e drejtorit, në dy forma të ndryshme, është e papranueshme dhe mund të bie në kundërshtim me ligjet pozitive në Kosovë që ndalojnë çdo formë të diskriminimit dhe po ashtu edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës e cila parasheh se gjithë njerëzit janë të barabartë të konkurrojnë ndërsa procedura dhe mënyra e zgjedhjes, mënyra e shpalljes së konkursit dhe të gjitha tjerat, janë të ndryshme brenda një institucioni. Dhe, si e tillë, kemi dyshime të bazuara se kjo mund të jetë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet pozitive në fuqi.

Prandaj, ne rekomandojmë që ky ligj të hiqet nga i ditës sot dhe të kalojë nëpër Komisionin për legjislacion, të shihet pajtueshmëria e tij me ligje tjera e po ashtu edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në momentin kur të vjen në seancë të mos ketë asnjë problem e të mos ndodhë që ky ligj të çohet pastaj ose në Gjykatë Kushtetuese ose diku tjetër dhe të kemi probleme në zbatimin tij.

Po e përsëris edhe një herë. Problemi kryesor është se zgjedhja e drejtorit të përgjithshëm të Radiotelevizionit të Kosovës bëhet me një procedurë, ndërsa propozimi për zgjedhjen e drejtorit të kanalit në gjuhën serbe, i cili pritet të hapet, propozohet të bëhet me një procedurë tjetër.

Prandaj, brenda një ligji, dy procedura për të njëjtin institucion, është e papranueshme dhe mënyra se si është draftuar mund të ketë konflikt me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ne si Grup Parlamentar propozojmë që kjo të shtyhet deri në seancën e radhës, sepse mund të shkaktojë konflikte. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, ky është mocion për ta heq një pikë nga rendi i ditës dhe unë jam i obliguar që mocionin ta paraqes për shqyrtim në seancë.

Kush e do fjalën nga përfaqësuesit e Grupit Parlamentar të PDK-ës lidhur me këtë? Nuk janë këtu! Qe, Ademi tash erdh. A ta lëmë këtë përfund, a si t'ia bëjmë?

Atëherë, përfaqësuesi i Qeverisë do të shprehet lidhur me mocionin që e ka kërkuar Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe zoti Kuçi e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

Unë besoj, mocionin që e ngriti zoti Gashi, është plotësisht i ligjshëm edhe me procedura që kërkohen dhe mendoj se Ligji për RTK-ën është përafuar deri në atë shkallë, që për një nen është diskutabil.

Unë kisha dashur për mirëkuptim të Kuvendit, besoj në emër të Qeverisë po e them, që në ndërkohë të shqyrtohen tjerat projektligje dhe të bëhet një pauzë që Komisioni për legjislacion, meqë është në pyetje vetëm një nen, mund ta shqyrtojë, e për nenet tjera ka harmonizim të plotë, dhe të mos e shtyjë për një periudhë tjetër.

Arsyeja kryesore, është kjo: E para, Ligji për RTK-ën është që dy vjet që jemi në Raport të progresit që po mungon dhe e dyta, atje ka pengesa edhe për pagesa elementare për pagat e punëtorëve, në mënyrë që ata të mos vijnë në pozitë që ta shtyjë edhe për një periudhë që do të bëhet pastaj një pengesë buxhetore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentarë të Vetëvendosjes, fjalën e ka deputetja Lama!

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ligji për RTK-ën është një nga më të rëndësishmit, që ne e kemi shqyrtuar gjatë gjithë kësaj kohe dhe është shumë e çuditshme se si po pengohet në mënyrë të vazhdueshme që ky ligj të miratohet.

Për të mos ardhur në këtë situatë të tillë, mendoj se ata që kanë votuar pro për këtë nen në Komision, është dashur të mendojnë pak më mirë se po vendosen precedentë shumë të rrezikshëm në demokraci. Pavarësisht nga kush vijnë kërkesat, qofshin ato minoritete apo jo, kjo është një situatë shumë e rëndë. Puna në RTK po pengohet, ligji duhet të miratohet.

Mirëpo, ne nuk mund të shkelim procedurat, sepse ky nen është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe për më tepër nuk ka kaluar në Komisionin për legjislacion dhe nuk ka kaluar as në Komisionin për integritet evropian.

Me këto nene, të cilat po futen fshehurazi, po cenohet drejtpërdrejt pavarësia e televizionit publik dhe ne nuk mund të bëjmë ligje ndryshe për një palë, ndryshe për një palë tjetër, sepse përndryshe çfarë kuptimi do të kishte shteti.

Gjithsesi ne jemi për shtyrjen edhe këtë javë, pavarësisht se deputeti ynë në Komisionin për media ka votuar kundër këtij neni dhe gjithsesi se nuk duam që Ligji për RTK-ën të kalojë pa e pa edhe Komisioni për legjislacion.

Ata që po bëjnë obstrukcione për miratimin e ligjit, kam përshtypjen se nuk janë minoritetet, por janë të tjerët në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Të faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-ës, a dëshiron të shprehet? Jo dhe është për. Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kryetari i Grupit zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Ne jemi dakorduar më herët dhe e mbështesim mocionin që e prezentoj në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, zoti Gashi. Mendojmë se nëse kemi pritur dy vite, mund të presim edhe një javë.

Ka nene të cilat duhet të votohen në këtë ligj dhe të cilat nuk kanë kaluar nëpër komisione, nëpër të cilat është dashur të kalojnë.

Domethënë, është shkelje serioze dhe ne mendojmë se nuk mund Komisioni për legjislacion të mbledhet tani dhe ta shqyrtojë një amendament për Ligjin i cili ka ardhur tani.

Po ashtu, mendojmë se nuk është problem i madh dhe Kuvendi mund të mbledhet javën tjetër dhe ta votojë Ligjin pasi të jenë harmonizuar qëndrimet e grupeve dhe amendamentet e propozuara të kalojnë nëpër komisione. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar, Koalicioni Kosova e Re, a dëshiron të shprehet? Jo, SLS? Jo, 6+? Jo.

Atëherë, unë jam i detyruar që ta vë në votim propozimin, sipas Rregullores.

(Ndërhyrje)

Po, urdhëroni! Fjalën e ka përfaqësuesi i Qeverisë! Siç e dini, vetëm përfaqësuesit e grupeve parlamentare kanë të drejtë të shprehen. Urdhëro, vazhdoni zoti Kuçi!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, për mirëkuptim zoti nënkryetar!

Unë mendoj që edhe në emër të Qeverisë, po tash po flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-ës, nuk e kemi qëllim që jetë ligj i njëanshëm. RTK është diçka që iu takon të gjithëve dhe duhet të pajtohemi të gjithë që ta shtyjme këtë çështje për javën tjetër. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Në rregull! Zoti Grabovci a e doni fjalën?

Ne, të paktën, nuk jemi të ndarë edhe si Grup Parlamentar nga Qeveria, kështu që në rregull është.

E vë propozimin në votim.

Kush është për, e kush është kundër mocionit që të shtyhet për seancën e ardhshme pika e tetë e rendit të ditës, që është: 8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit Numër 04/L-46 për transmetimin publik në Kosovë?

Votojmë tash:

Konstatohet se miratohet propozimi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Ligji shtyhet për shqyrtim në seancën e ardhshme. Faleminderit!

Tani kemi ardhur, siç thash, në pikën e katërt qysh e kemi pasur më herët, që tash realisht është bërë pikë e pestë. Dhe, meqenëse e filluam, po vazhdojmë ta shqyrtojmë:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për komunikimet elektronike.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin për Zhvillim Ekonomik, zotin Beqaj, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar nënkryetar,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të paraqes për miratim Projektligjin për komunikimet elektronike.

Ky projektligj është plotësim-ndryshim i Ligjit për telekomunikacionin Numër 2002/7 që është paraqitur si nevojë për mbulimin dhe përcjelljen e zhvillimeve shumë të hovshme

teknologjike dhe të shërbimeve përcjellëse që kanë ndodhur dhe po ndodhin në vazhdimësi në fushën e komunikimeve elektronike.

Në Kosovë ky sektor ka rëndësi shumë të madhe ekonomike, me faktin që në dhjetë vitet e fundit merr pjesë në GDP të Kosovës për rreth 10%. Përveç rëndësisë ekonomike, ky sektor ka ndikim shumë të madh edhe në kohezionin social, në sferën e edukimit, të shëndetësisë, në ngritjen e kapaciteteve njerëzore në përgjithësi si dhe në ngritjen e konkurrentshmërisë së përgjithshme të Kosovës në nivelin global.

Miratimi i këtij projektligji paraqitet edhe si nevojë për përafrimin apo edhe harmonizimin me legjislacionin evropian, respektivisht vendosjes së një kornize gjithëpërfshirëse ligjore në harmoni me direktivat e Bashkimit Evropian.

Ky projektligj rregullon marrëdhëniet shoqërore që kanë të bëjnë me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, shërbimet me mjete shoqëruese, përdorimin e burimeve të komunikimeve elektronike si dhe të marrëdhënieve shoqërore që kanë të bëjnë me radio-pajisjet, pajisjet fundore dhe përputhshmëritë elektro-magnetike.

Qëllimi i këtij projektligji është që nëpërmjet parimit të neutralitetit teknologjik, të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet elektronike, si dhe të garantojë shërbime të duhura e të përshtatshme në territorin e Republikës së Kosovës.

Projektligji për komunikimet elektronike, ndër të tjera, parashikon edhe kalimin nga regjimi i licencave në regjimin e autorizimeve të përgjithshme, përafrimin e përgjithshëm dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike. Kjo nënkupton arritje të mundësive dhe përmirësim cilësor të ambientit për investime të reja dhe konkurrencës së drejtë e lojale, që është edhe një nga synimet themelore të Qeverisë.

Një operator i ri potencial që është i interesuar të ofrojë shërbime për rrjete të komunikove, nuk do të ketë nevojë të pajiset me licencë për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve nëse nuk shfrytëzon resurse të fundme siç janë frekuencat dhe numrat. Operatori i ri duhet vetëm t'u përmbahet kushteve dhe rregulloreve për ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, të përcaktuara nga ky ligj dhe legjislacioni sekondar në implementim të këtij ligji.

Ndërsa, nëse shfrytëzon resurse të fundme, spektre frekuencore apo numeracion, atëherë ai duhet t'i nënshtrohet edhe procedurave të drejta garuese dhe normalisht paguan për shfrytëzimin e resurseve të ndara për të. Shfrytëzimi i frekuencave dhe numrave si dhe procedura për marrjen në shfrytëzim të këtyre resurseve janë qartësuar dhe bëhen në mënyrë shumë transparente.

Ky ligj rregullon statusin, strukturën organizative, fushën e veprimit, autorizimet dhe financimin e autoritetit rregullator nacional përgjegjës për komunikimet elektronike në Republikën e Kosovës. Ky autoritet është pasues i drejtpërdrejtë i autoritetit rregullativ të telekomunikacionit.

Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet fuqizimit të kapaciteteve institucionale dhe përmirësimit të efikasitetit të strukturës së këtij autoriteti rregullator nacional.

Dispozitat përkatëse të këtij ligji reflektojnë praktikën më të mirë të organizimit strukturor të këtyre autoriteteve në vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Me këtë do të arrihet niveli i lartë i realizimit të objektivave dhe detyrave rregullatore, duke siguruar nivelin më të lartë të përgjegjësisë së autoritetit rregullativ.

Me dispozitat e caktuara ligjore qartësohet dhe kërkohet nga autoriteti transparencë dhe llogaridhënie për veprime të veta.

Në këtë projektligj, përshihen edhe dispozitat për shërbimet universale, të cilat janë në përputhje të plotë me kornizën ligjore të Bashkimit Evropian.

Procedura e shpalljes së ofruesve të shërbimeve universale nënkupton edhe procesin e konsultimeve të hapura në të cilat operatorët mund të shprehin pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre mbi pjesëmarrjen dhe ofrimin e shërbimeve universale.

Në këtë projektligj specifikohen masat për të mbrojtur konsumatorët, veçanërisht me dispozitat të cilat kanë të bëjnë me formën dhe përmbajtjen e kontratave, standardet e abonimit dhe publikimin e tyre, duke përfshirë edhe referencat e çmimeve të shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Pjesë e rëndësishme e këtij ligji, janë dispozitat për kushtet e ndërtimit, të instalimit, përdorimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës për komunikime elektronike, duke siguruar të drejtat për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës së ndërtuar, përfshirë edhe kanalet nëntokësore, kablovike dhe shtyllat e antenave në përputhje me dispozitat në fuqi të kornizës ekzistuese ligjore të Bashkimit Evropian.

Pra, Projektligji për komunikimet elektronike vendos një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore që do të jetë në harmoni me direktivat e BE-së dhe në përgjithësi në harmoni me aquil komunitare.

I tërë procesi gjatë hartimit të Projektligjit ka qenë mjaft bashkëpunues dhe transparent. Në grupin punues kanë marrë pjesë të gjitha palët e interesit. Gjithashtu procesi ka qenë bashkëpunues edhe ndaj palëve tjera të interesit respektivisht drafti është shpërndarë për më shumë se një muaj dhe pastaj janë realizuar edhe takime të veçanta me palë të interesit, siç janë operatorët e rrjeteve të shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Andaj, të nderuar deputetë, duke konsideruar të rëndësishëm faktin se ky projektligj rregullon edhe nevojën për plotësimin e kornizës ligjore në sektorin e komunikimeve elektronike si parakusht për një zhvillim të qëndrueshëm dhe me perspektivë të tregut të komunikimeve, ju rekomandoj ta miratoni në parim këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani hap diskutimin në parim.

Sipas rregullës, për fjalë e ka radhën kryetari i komisionit funksional. Nuk është këtu!

A e dëshiron ndokush fjalën në emër të Komisionit? Jo!

Tash, radhën për të marrë fjalën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të PDK-ës, fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje kryeministër Thaçi,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Unë nuk kisha diçka më tepër për t'i shtuar këtij projektligji, përveç asaj që në ekspozitën e vet e tha edhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, por në këtë rast po shfrytëzoj rastin që po e diskutojmë Projektligjin për komunikimin elektronik dua të përshëndes gatishmërinë e Universitetit të Prishtinës që nga muaji prill do të fillojë aplikimin e paraqitjes së provimeve pikërisht në mënyrën elektronike, pra online.

Këtë projektligj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka analizuar me vëmendje dhe e mbështet në parim. Është një projektligj që e përplotëson sferën në këtë drejtim dhe vërejtjet dhe sugjerimet tona do t'i japim në fazën e amendamentimit, në komisionin funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka zonja Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryesues!

Fusha e komunikimeve elektronike deri sot është rregulluar me Ligjin për telekomunikacion. Tani, kjo fushë pritet të rregullohet me Ligjin për komunikime elektronike që e kemi sot, me Ligjin për shërbimet e shoqërisë informatike, të cilën sot do ta kemi në shqyrtim të dytë, si dhe Ligjin kundër krimit kibernetikë.

Në përshkrimin e këtij projektligji, të dërguar nga ministria, thuhet se mëton t'i rregullojë marrëdhëniet shoqërore që kanë të bëjnë me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, si dhe marrëdhëniet shoqërore që kanë të bëjnë me radio pajisje dhe përputhshmëri elektromagnetike. Kurse, neni 4.1.3 me titullin "fascilitetet shoqërore" na bën me dije që në komision me të vërtetë do të kemi punë që të merremi me plotësimin e fjalorit tonë me fjalë të reja.

Kjo përsëri po tregon që në këtë propozim ligji si me shumë ligje tjera që na vijnë do të përballemi me përkthime jo adekuate, gabime gjuhësore, por edhe gabime në kuptim substancial.

Me analizimin e këtij ligji nën për nën, shohim që në mjaft nene, sikur që është neni numër 28, neni 47, neni 68 e sidomos neni 84 janë nene me të vërtetë të stërzgjatura ku është përdorur një gjuhë më shumë sqaruese se sa normative dhe këto nenet që i përmenda shkojnë prej 2 deri në 4 faqe në më shumë sqarime se normativ.

Është një fenomen tjetër i afateve interesante, ku përmenden 5 ditë, 4 muaj, 9 muaj, 28 ditë e tjera, e tjera.

Nenet tjera duke i analizuar prej nenit të parë deri në 110, se janë në këtë ligj voluminoz, shihet që në mjaft nene do të duhej të ketë riformulime çfarë është neni: 1, 7, 8 e të mos i përmendi tjerat.

Në mjaft nene mungojnë sqarimet për shembull në afatet në nenin nr. 10, por gjithashtu edhe neni 15, 16 dhe deri në fund janë shumë nene, të cilat kërkojnë sqarime shtesë për materialin në këto nene.

Mendoj që në nenin 4, duhet të plotësohet nocioni teknik linja e pa komotuar që do të duhej të jetë në përkufizime në mënyrë që neni të jetë më sqarues dhe në mjaft nene përsëri mungojnë referencat, po edhe rregullimi teknik është shumë i nevojshëm.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik në këtë projektligj shihet që nuk ka paraqitur ndonjë vlerësim detal të ndikimit buxhetor, kur ka thënë se nuk ka implikime shtesë, gjë për të cilën Departamenti i buxhetit shpreh rezerva, po edhe Ministria e Financave.

Sidomos, kur kihet parasysh dokumente që duhen aprovuar nga neni 6, i këtij projektligji, plani kombëtar i radio frekuencave edhe politika dhe strategjitë kombëtare në sektorin e komunikimeve elektronike, të cilat do të kërkojnë edhe mjete shtesë.

Neni 8.2 e po ashtu edhe neni 78 thotë se autoriteti është person jo buxhetor, ndërsa neni 81 se buxhetin e autoritetit e miraton Kuvendi.

Mendojmë se këtu duhet qartë të përcaktohet financimi i autoritetit nga të hyrat dhe si të hyrat tjera duhet t'i takojnë buxhetit të Kosovës. Këto japin një pasiguri lidhur me aprovimin e ligjit, duke pasur parasysh ndikimin buxhetor.

Kjo gjë bëhet më serioze kur kemi parasysh se buxheti i Kosovës nuk planifikon buxhet shtesë që mund të kërkojë ky ligj. Prandaj, mendojmë që ministri i Zhvillimit Ekonomik do të duhej të na jep një sqarim se si e ka menduar financimin e këtij ligji, pra për implikimet buxhetore të këtij ligji.

Autoriteti rregullativ i komunikimeve elektronike dhe postë duhet të definohet si organizatë buxhetore me financim të qartë dhe transparent.

Më tej në këtë projektligj thuhet: “krijohet baza ligjore për heqjen e çdo licence dhe çdo person i cili dëshiron të ofrojë shërbimet dhe rrjeta komunikuese” dhe këtu përsëri roli i tash jo ART po ARKEP do të duhet të precizohet më mirë.

Në ligj në mënyrë të stërzgatur përshkruan edhe kompetencat si të KPMM-ës, ministrisë, autoritetit, inspektoratit e tjera. Projektligji, që e kemi këtu, do të duhet të përpunohet më detajisht në Komision, ku me vëmendje të posaçme do të marrim pjesë në amendamentim.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Vetëvendosje, zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e ka shqyrtuar këtë ligj dhe i kemi vërejtur ose i kemi disa vërejtje në të, disa prej të cilave janë më të theksuara dhe më të rëndësishme, të cilat do t'i përmendi këtu dhe natyrisht të tjerat do t'i japim edhe përmes komisionit funksional.

Në radhë të parë, ligji ka shumë nene të them ashtu dhe rregulla të cilat është vështirë t'i zbatojmë në gjendjen në të cilën është aktualisht ky sektor në Kosovë. Pra, ka goxha pengesa për ushtrimin e obligimeve që dalin nga ky ligj duke u bazuar edhe në gjendjen ekzistuese në enumeracionin telefonik i cili është në Kosovë, në të cilin ka goxha një masë të konsiderueshme të kaosit dhe po ashtu gjendja të cilën e kemi, domethënë në tregun në të cilën operojnë siç e dimë edhe operatorë të huaj - e ka vështirësuar që të kemi një zgjidhje të favorshme për Kosovën në këtë drejtim. Pra, e dimë që telefonatat që vijnë nga jashtë domethënë përveç nga Republika e Serbisë ato terminohen edhe në Monte Karlo edhe në Lubjanë, respektivisht varësisht edhe prej operatorit të cilin e përdorim. Dhe, këto përveç që janë një burim i mirë i të ardhurave për ata operatorë në fjalë e kanë edhe ndikimin e tyre natyrisht në Kosovë ku na pengon të bëjmë zgjedhje të kënaqshme në fushën e komunikimit elektronik.

Po ashtu, do ta kemi parasysh edhe realitetin në Kosovë, të cilin ky ligj njëfarë mënyre edhe e mohon që ta përmend, është se ka ende operatorë qoftë të telekomunikacionit postar, radio-difuziv e terë, madje edhe operatorë shtetëror të Republikës së Serbisë, të radiove të Ministrisë së Punëve të Brendshme më saktësisht në territorin e Kosovës, të cilat ende funksionojnë dhe ato duhet të trajtohen ose të ndalohen përmes këtij ligji.

Është një çështje tjetër e rëndësishme që u përmend edhe nga ministri, domethënë është edhe ky misioni shoqëror i telekomunikimeve dhe vërehet që edhe në ligj po edhe në realitetin që e kemi në disa raste dhe veçanërisht në disa operatorë është tendenca e shtrirjes së rrjetit vetëm duke e përdorur logjikën e biznesit. Pra, aty ku ka përfitime aty edhe shtrihet rrjeti. Ndërkohë që obligimi shoqëror, kisha me thënë edhe i operatorëve, do të kishte me qenë tjetër dhe mendojmë që me ligj duhet të imponohet edhe obligimi shoqëror, pra që edhe zonat e banuara të kenë mbulim doemos edhe të telefonisë mobile edhe të telefonisë fikse, pavarësisht nivelit ose të masës së përfitimit që mund të nxjerrin nga ato.

Po ashtu, te neni 7 kisha dashur me tërheq vërejtjen, që këtu duhet të kujdesemi që Qeveria ta sigurojë mosprekjen e kësaj pjese të sovranitetit, domethënë në fushën e komunikimeve elektronike dhe këtu duhet që disa prej klauzolave të këtij neni, i cili në njëfarë mënyre i përcakton edhe përgjegjësitë e ministrisë në këtë fushë, duhet që ta qartësojnë këtë gjë.

Një çështje tjetër që kisha dashur me e përmend këtu, është edhe çështja e bordeve te kreu 12, mbuluan bordet dhe ne mendojmë që në borde duhet të kemi edhe anëtarë nga

shoqëria. Pra, një lloj, të them ashtu, riformimit të qeverisjes korporatiste të ndërmarrjeve ku edhe ata që mund të quhen hisedarë në shërbimin që ofrohen do të duhej të ishin të përfaqësuar në borde e jo ta kemi vetëm njërën palë të përfaqësuar në borde.

Dhe çështja e fundit me të cilin kisha dashur ta përfundoj këtë fjalë timen për këtë ligj, është te kreu 6. Aty ka mundësi edhe i hap rrugë njëfarë mënyre rrudhjes së tregut të Valës, për shkak se ia lë hapur mundësinë operatorëve virtualë të telefonisë mobile që të funksionojnë në Kosovë dhe të kyçen në rrjetin e Kosovës, gjë që ne mendojmë që nuk do të duhej të ndodhte, për shkak se e kanë dëmtuar shumë rëndë, pra edhe atë një operator që e kemi e ka dëmtuar shumë rënd kompaninë publike, veçanërisht telefoninë mobile të Valës 900.

Vërejtjet tjera, të cilat i kemi natyrisht që do t'i shtrojmë përmes komisionit funksional dhe ne e miratojmë këtë ligj në parim, duke i pasur parasysh edhe këto vërejtje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar i AAK-së, deputetja Kadaj - Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, kryesues!

Po edhe na i kemi vërejtjet tona, duke filluar nga mungesa e harmonizimit të sektorëve, në rend të parë Qeveria ndërmjet veti e pastaj të sillet në Kuvend një projektligj.

Për shembull, është shqetësuese opinioni i Departamentit të buxhetit i cili ka shumë dilema sa i përket kostos shtesë të këtij projektligji. Ndërkaq ka kërkuar që të kemi edhe një dispozitë apo projektligji të plotësohet me një dispozitë e cila e mundëson zbatimin e legjislacionit brenda fondeve buxhetore që i kanë në dispozicion institucionet buxhetore të ndikuara, po kjo dispozitë nuk është sjellë.

Pastaj, konsideroj se kjo po tregon edhe një herë që Qeveria në vazhdimësi ka problem me e planifikuar sponsorizimin e ligjeve dhe përfshirjen e kostos buxhetore. Për shembull, as për 3 muajt e ardhshëm nuk po e kemi të saktë se a ka mundësi të zbatohet ligji i cili kalon në Kuvend apo jo. Pra, është një dobësi që në vazhdimësi po përsëritet në aspektin e bërjes së politikave.

Në anën tjetër projektligji, do të thotë, duhet të lirohet nga dispozitat ligjore që janë paqarta ose janë të pasakta, për shembull, paragrafi pra kur është fjala, te paragrafi 1 i nenit 71, që thotë: “jo buxhetor”.

Domethënë është viti i katërt që kjo Qeveri është në pushtet dhe po hasim në disa gabime, të cilat s'guxojnë me ndodh, edhe sa i përket drejtshkrimit edhe substancës dhe kuptimit të ligjeve, sepse atëherë po duhen komisionet përkatëse në të shumtën e rasteve me sponsorizuar më shumë amendamente se vetë sponsorizuesi ose me e heq gjysmën e ligjit dhe ajo nuk është në rregull.

Konsideroj se ne në parim, ashtu si edhe grupet tjera, do ta mbështesim, mirëpo ka shumë punë për tu bërë në mënyrë që ky projektligj të jetë i zbatueshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, fjalën e ka zoti Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke e përshëndetur ardhjen e këtij projektligji në Kuvendin e Kosovës, Koalicioni për Kosovë të Re do ta votojë në parim.

Vërejtjet dhe sugjerimet tona në lidhje me këtë projektligj do t'i adresojmë në komisionin funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për 6+, zoti Kinolli!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar 6+ e ka bërë shqyrtimin dhe analizimin e këtij projektligji dhe në parim do të votojmë për këtë projektligj, ndërsa vërejtjet tona do t'i japim përmes komisionit funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e deputetëve. Fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: I nderuari, kryesues!

Zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Deputetë,

Ky ligj është jashtëzakonisht i rëndësishëm që të aprovohet, mirëpo mendoj se nga opinionimi im edhe nga analizat të cilat jam munduar t'i bëj ka disa mangësi, të cilat nuk do të lejojnë që të jetë funksional që praktikë.

Nga organizimi nëse kthehet retrograd e analizohet si është organizuar zhvillimi i teknologjisë së informacionit në tërë dikasteret e ministrive deri më tani dhe ka mangësi të shumta. Ndërsa, nëse analizohet edhe investime janë të mëdha, që nuk janë duke dhënë rezultate të mjaftueshme.

Unë propozoj që në këtë ligj të futet edhe një formë tjetër e organizimit dhe përveç bordeve të jetë e organizuar në formën e nivelit të Ministrisë së Teknologjisë dhe Informacionit, nëse duam të vjelim informacione dhe të jetë i aplikueshëm në praktikë.

Në të kundërtën ne do të kemi një fragjilitet, një shpërndarje të këtij ligji nëpër shumë institucione, në të cilat do të kemi një mundësi të ishujve elektronikë që nuk do funksionojnë në mes veti dhe në atë mënyrë do të bindesh edhe me ligjin më poshtë që e kemi në leximin e dytë të shoqërisë informative që do ta aprovojmë.

Prandaj, kontributi ynë duhet të jetë shumë i fokusuar dhe propozoj që Qeveria dhe Kuvendi ta analizojnë që të ngritët në nivel të Ministrisë së Teknologjisë së Informacionit që është shumë e dobishme për zhvillimin ekonomik të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI. Faleminderit! Zoti Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: I nderuari, kryesues zoti Haliti!

I nderuari kryeministër zoti Thaçi,

Të nderuar ministra dhe,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Për nga rëndësia strategjike dhe ajo për sigurinë kombëtare Projektligji për komunikimet elektronike është njëri prej dokumenteve më të rëndësishëm.

Ky ligj ka rëndësi të veçantë edhe për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Ky ligj me 266 faqe dhe me 110 nene është mjaft voluminoz dhe gjithëpërfshirës. Ka një stil të rëndë të shprehjes, i ngarkuar edhe me terminologji profesionale, prandaj nuk është aq i lehtë që të kuptohet.

Që në fillim më duhet të them se sipas këtij dokumenti, pothuaj të gjitha kompetencat janë të koncentruara te Autoriteti rregullativ i komunikimeve elektronike dhe postare. Për këtë arsye ai duhet të jetë i organizuar mirë dhe i kompletuar me kuadro, jo vetëm për shkak të kompetencave që ka, por edhe për shkak të nevojës për bashkëpunim me shumë akterë të rëndësishëm në treg.

Ligji precizon se ai duhet të jetë në koordinim të përhershëm me rreth dhjetë institucione dhe me qëllim që puna të mos ngecë të gjitha këto institucione duhet të jenë të koordinuara mirë. Ndërkaq, ligji nuk cakton format se si duhet të ndërtohet ky bashkëpunim apo të caktojë afate kohore për kryerjen e këtyre punëve.

Në mënyrë të përgjithësuar për procedurat dhe format e bashkëpunimit bëhet fjalë në nenin 14, pika 13, të cilën edhe do ta citoj: “mund të rregullohen me marrëveshjen ndërmjet institucione të tilla”.

Neni 18, pika 7 thuhet se kur kërkohet një informacion autoriteti duhet të informojë ndërmarrësit për qëllim specifik për të cilin ky informacion do të përdoret, por aty nuk caktohet ndonjë afat kohor, së paku për përgatitjen e informacionit.

Neni 25 rregullon servitutin për instalimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike. Sipas këtij neni, në rast të mosmarrëveshjes, mund të bëhet aplikim në gjykatë për dhënien e së drejtës.

Në rast se nuk merret vesh rreth ngritjes së infrastrukturës dhe instalimeve e stabilimenteve, atëherë ofertuesi i shërbimeve mund të aplikojë në gjykatë. Mirëpo, këtu nuk saktësohet se cila është gjykata kompetente për rastet e këtilla dhe brenda të cilit afat kohor ajo duhet të vendosë.

Kjo çështje është me rëndësi posaçërisht kur merret parasysh se bëhet fjalë për aktivitete biznesore dhe për një veprimtari specifike. Kurse, zvarritjet e afateve mund të përfundojnë me dështimin apo vonimin e punëve të planifikuara.

Neni 26 bën fjalë për mbrojtjen e rrjeteve publike të komunikimeve. Në pikën 1 thuhet se zona e mbrojtur përbëhet nga një rrip toke përgjatë linjave komunikuese me tela, e tjera. Mirëpo, nuk thuhet saktësisht se çfarë gjerësie dhe gjatësie është ky rrip, dhe në baza të cilave kriteret teknike përcaktohet ai.

Neni 47 lidhur me resurset e komunikimeve elektronike në pikën 3 thotë se personi që kërkon radio-frekuenca ose kanale, duhet t'i ofrojë autoritetit informata për mundësitë dhe aftësitë e përmbushjes së obligimeve, por nuk thuhet se cila është natyra dhe përmbajtja e këtyre informatave dhe në të cilin afat kohor ato duhet të ofrohen.

Pika 10 pos tjerash thotë dhe po e citoj: “vendimi për dhënie të resurseve duhet të merret, të komunikohet, të jetë aplikuese dhe të bëhet publike sa më shpejtë që është e mundur”.

Në vazhdim është një konfuzion, meqenëse përmendet afati kohor prej 21 ditësh dhe 42 ditësh, por nuk është shumë e qartë se çka duhet të ndodh brenda këtyre afateve.

Pika 11 e këtij neni, parasheh mundësinë që resurset të jepen edhe me tenderë, por nuk përcakton kushtet dhe kriteret e tenderit, si dhe formën dhe nivelin e pagesës.

Më poshtë përkatësisht në nenin 50 bëhet fjalë për tenderin. Atëherë të njëjtat kushte do të duhej të vlejnin edhe për nenin 47 dhe kjo duhet të thuhet qartë edhe në nenin 47.

Neni 52, refuzimi për dhënien e resurseve në pikën 2, thotë se para marrjes së vendimit refuzues autoriteti mund të caktojë afat kohor shtesë për personin për të rregulluar çështje të cilët e kanë detyruar autoritetin që të marrë vendim refuzues. Për sa kohë bëhet fjalë, kjo nuk është e saktësuar.

Po ashtu, në rast refuzimit të dhënies së resurseve, palës së interesuar nuk i lejohet mundësia për ankesë pranë gjykatës.

Në nenin 68, bëhet fjalë për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave për qëllimet e ndjekjes penale. Së pari thuhet se fajllat duhet të ruhen jo më gjatë se një vit, që afati është i gjatë dhe kjo mund t'i krijojë problem operatorit. Po ashtu, në këtë kaptinë nuk thuhet se kush mund t'i shfrytëzojë këto informata dhe në cilat rrethana i lejohet qasja individit apo institucionit kompetent.

Neni 72, zgjedhja e mosmarrëveshjeve, bazuar në ankesat e shfrytëzuesit fundor, në pikën 1 thuhet se shfrytëzuesi, citoj: “mund t'i drejtohet autoritetit të për zgjidhjen e mosmarrëveshjes para se çështja të shkojë në procedurë gjyqësore”.

Mirëpo, ky ligj nuk e obligon autoritetet që brenda afatit të caktuar kohor të kthejë përgjigje, me çka ai krijon një pozitë të paprekshme në raport me shfrytëzuesin.

Në nenin 74, cakton rrethanat kur mund të shkyçet parapaguesi, por atij nuk i ofrohet asnjë mundësi që të parashtrojë ankesë, të shkëpusë kontratën apo të kërkojë kompensim nëse operatori nuk i është përmbajtur kontratës.

Kur është në pyetje funksionimi i autoritetit të komunikimeve elektronike dhe postare, kam vërejtje te neni 78, ku thuhet se, citoj: “Në rast se mandati i bordit përfundon, bordi ekzistues duhet të vazhdojë t’i kryejë funksionet e tij, derisa të zgjidhet bordi i ri.

Propozoj që ky nen të fshihet, meqenëse ofron mundësinë që bëhet lojë me afate, posaçërisht pse në këtë ligj nuk janë caktuar as rrethanat, kur nuk mund të zgjidhet bordi i ri dhe kur duhet vazhduar mandatin bordit të vjetër.

Por, kam edhe disa vërejtje tjera në këtë projektligj, por kontributin tim do ta jap në komisione dhe në parim e mbështes këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk ka të tjerë të paraqitur. Përfaqësuesi i Qeverisë... s’ka nevojë.

Në vazhdim po futemi në procedurën e votimit.

Në mbledhje janë prezentë 81 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Faleminderit!

Konstatohet se me 77 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për komunikimet elektronike.

Kërkohej nga Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Po vazhdojmë tani me miratimin e propozimit të mëparshëm të Rezolutës, i cili u propozua nga grupet parlamentare.

Fjalën ia jap zotit Adem Grabovci, që të na sqarojë lidhur me harmonizimin e tekstit që është bërë.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

KRYESUESI: Në këtë rast, pasi je përfaqësues i të gjitha grupeve që kanë propozuar Rezolutën.

ADEM GRABOVCI: Ne, siç vendosi Kuvendi, shefat e grupeve parlamentare u konsultuam, me ndryshimet e propozuara në debat, u pajtuam shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, LDK-së, AAK-së, i “Vetëvendosje”-s, AKR-së, SLS-it dhe “6+”-it, që Rezoluta të ketë këtë përmbajtje

1. Theksojmë se është shkelje e sovranitetit dhe cenim i marrëdhënieve të mira fqinjësore, që të organizojë në mënyrë të njëanshme zgjedhje të përgjithshme dhe lokale, në një shtet tjetër evropian.

2. Pika 2, është riformuluar sipas propozimit, kryesisht të profesor Sabri Hamitit. Konkludojmë se Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk lejon mbajtje të zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë dhe obligohet Qeveria të realizojë këtë vendim.

Dy pikat tjera janë të pandryshueshme. Besoj se nuk ka nevojë të lexohen, prandaj u bëj thirrje të gjithëve që të votojmë këtë Rezolutë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Debati është kryer në pjesën e paradites. Vazhdojmë, e hedh në votim, në qoftë se s'ka tjetër mendim. Nga grupet parlamentare nuk ka të paraqitur. Votojmë tani!

Në sallë janë 86 deputetë. Faleminderit!

Konstatoj që me 76 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Rezolutën e paraqitur në emër të gjitha grupeve parlamentare.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës, që është

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për deminimin humanitar

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për deminim humanitar dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj raportuesin e Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, deputetin Anton Quni, që para deputetëve të arsyetojë Raportin me rekomandime.

Zoti Quni, e keni fjalën.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

Aktualisht, aktiviteti i deminimit humanitar menaxhohet nga KFOR-i. Me miratimin e këtij projektligji, kompetencat dhe përgjegjësitë për ushtrimin e këtij aktiviteti, i kalojnë Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, përkatësisht Qendrës Koordinuese për Deminim Humanitar.

Ky ligj përcakton aktivitetin e deminimit humanitar, institucionet kompetente për deminim humanitar, kushtet dhe kriteret për akreditimin, suspendimin dhe anulimin e organizatave, të cilat merren me aktivitetin e deminimit humanitar.

Komisioni, në bazë të raportit të vet dhe raporteve të komisioneve kryesore, e miratoi raportin përfundimtar për projektligjin në fjalë dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë

rekomandimin, që të miratohet Projektligji për deminimin humanitar, me amendamentet e propozuara në vijim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Janë të propozuara gjithsej 7 amendamente nga Komisioni funksional.

Po vazhdojmë votimin e tyre.

Amendamenti 1.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër, s'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër, s'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Përgatitemi për votim.

Në sallë janë 82 deputetë.

Votojmë tani.

Konstatohet se me 76 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për deminim humanitar.

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës që është

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj raportuesin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, deputetin Anton Quni, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Zoti Quni e keni fjalën.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

Me Projektligjin për pensione të pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës:

- Bëhet rregullimi dhe harmonizimi i pagesave financiare për pjesëtarët e FSK-së, pas ndërprerjes së shërbimit të tyre në FSK,
- Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të FSK-së në rastet e pensionimit të tyre,
- Trajtimi i tyre në rastet e gjymtimit,
- Të drejtat e trashëgimtarëve në rastet e vdekjes së pjesëtarit të FSK-së,
- Kushtet për realizimin e këtyre të drejtave, si dhe
- Obligimet e pjesëtarëve apo trashëgimtarëve në rastet e ndryshimit të rrethanave.

Ky projektligj vlerësohet me ndikime buxhetore në buxhetin e Republikës së Kosovës, duke prodhuar kosto shtesë buxhetore.

Komisioni në bazë të raportit të vet amendamentues dhe raporteve të komisioneve kryesore e miratoi raportin përfundimtar për këtë projektligj dhe të njëjtin e paraqet në miratim.

Duhet të theksoj se janë në pyetje gjithsej 11 amendamente. 2 amendamente, numri 6 dhe i 11-ti janë të propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa. Amendamenti 6 e ka, po ashtu, edhe miratimin e Komisionit të Sigurisë, kurse amendamenti 11, është pa pëlqimin e Komisionit të Sigurisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Janë paraqitur Liburn Aliu dhe Safete Hadergjonaj, për ndonjë amendament të veçantë apo për ligjin.

(Ndërhyrje: Për amendament.)

KRYESUESI: Për cilin amendament doni ta merrni fjalën?

(Ndërhyrje: Të njëmbëdhjetin.)

E po, kur të vjen i njëmbëdhjeti, atëherë paraqituni!... Hiqni emrat dhe paraqituni atëherë, kur ta kalojmë të dhjetin.

Faleminderit!

Fillojmë votimin.

Amendamenti 1.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 6. Komisioni për Buxhet dhe Financa, me përkrahjen e Komisionit Funkcional.

A ka dikush ndonjë vërejtje, lidhur me këtë? Nuk ka.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 11.

Fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit Qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka bërë një plotësim tek neni 27, duke shtuar paragrafin 2, i cili ka ardhur pa përkrahjen e Komisionit funksional, megjithatë, unë kisha kërkuar nga Komisioni funksional, që të pajtohet që ta miratojë këtë amendament dhe kisha kërkuar nga të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës, ta miratojnë amendamentin, të cilin e ka propozuar Komisioni për Buxhet dhe Financa, sepse çështja e cila është trajtuar në këtë nen apo në amendamentin 11, në pikën 2, që kemi shtuar, të nenit 27, është pjesë e marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar, i cili duhet gjithsesi të miratohet.

Prandaj, kisha kërkuar nga deputetët që ta miratojnë amendamentin 11.

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Njëjtë edhe unë kam vërejtjen, pra, te amendamenti 11. Natyrisht, natyra e vërejtjes time është në të kundërtën me atë nga Komisioni për Buxhet dhe Financa. Unë kërkoj nga deputetët, që të mos e votojnë këtë amendament, pasi që sipas këtij amendamenti, Qeverisë i jepet e drejta pra, që të lëshojë një vendim, që redukton apo eliminon çfarëdo beneficioni të siguruar me këtë ligj, përfshirë beneficionet që kanë të bëjnë me pagesa financiare, madje nëse janë përvetësuar fondet, sipas këtij ligji të buxhetit të aplikueshëm në atë kohë. Bëhet fjalë për situatat kur janë rrethanat e paparapara, pra, që krijojnë tendosje të paparapara fiskale në buxhetin publik.

Pra, me këtë amendament, Qeverisë i jepet e drejta, që t'ua ndalojë pensionet komplet, në rast se kemi krizë dhe kreyt kjo trajtohet, quhet si një lloj ruajtje e disiplinës fiskale.

Së pari, mund të parashohim që mund të ketë krizë. Vërtet, në politikën çfarë po shkon Qeveria jonë, do të shkojmë pashmangshëm drejt një krize dhe e drejta e Qeverisë, që të mund t'i eliminojë komplet pensionet, është një e drejtë arbitrare që nuk duhet të lejohet. Ndërsa, kur bëhet fjalë për disiplinimin, do të duhej ta dinim, se kënd tjetër e dispiplinojnë këto lloj nenesh. Neve po na vijnë këto nene në ligje të ndryshme, sidomos në ato kategoritë sociale, tek pensionet te skemat sociale e tek të gjithë të tjerët, kështu që kanë të bëjnë pra, që janë kategori që marrin ndihmat apo pensionet direkt nga shteti.

Pra, nëse ky disiplinim bëhet vetëm për këto kategori, atëherë ne do t'i kemi të parët, që do t'i sakrifikojmë në situata krizash, pikërisht ata që marrin ndihmat. Do të duhej, që të jepet një pasqyrë e qartë, që në rast krize, nëse ka shkurtime buxhetore, cila është strategjia e Qeverisë, ku, kujt i merr, sa, çfarë shkurton dhe kujt i ndalon të ardhurat, po jo kështu në mënyrë të veçantë, ligj, nen pas neni në ligje të ndryshme, ku një nen mund të kalojë, një nen tjetër mund të mos kalojë dhe i bie, që disa pensionistëve të ketë Qeveria të drejtë t'ua shkurtojë pensionet, disa të tjerëve jo, sepse nuk kalojnë kështu?

Dhe normalisht, disa të tjerë, milionerëve, që në rast, sepse nuk e parasheh ligji askund që atyre diçka t'iu ndalet, kjo thjesht, në këtë mënyrë se si vjen këtu tek ne, që duhet të trajtohet, është mënyrë diskriminuese e trajtimit, prandaj, nuk duhet të votohet. Nuk duhet të krijojmë mundësi, që ta zëmë tani për pensionistët e FSK-së, të ketë të drejtën Qeveria në mënyrë arbitrare, në një moment të caktuar t'ua ndalojë komplet pensionet.

Prandaj, unë kërkoj që të mos votohet ky amendament, sepse është i gabueshëm.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Hadërgjonaj, po dëshiron të sqarojë edhe diçka, në emër të Komisionit, po dihet.

SAFETE HADËRGJONAJ: Po e shoh të arsyeshme e të nevojshme, që të sqarohen edhe pak më tepër në lidhje me këtë amendament, që ka propozuar Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Unë kam për obligim që t'i njoftoj të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës, që ne jemi në prag të zyrtarizmit të një marrëveshjeje me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe kisha kërkuar nga deputetët, që të mos rrezikojmë në nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Nuk kjo çështje vetëm pjesë e këtij ligji, por është pjesë edhe e ligjeve tjera. Domethënë, nuk është që po ndodh një precedan në këtë projektligj, por është edhe në pjesë të ligjeve tjera, sepse një çështje e tillë është pjesë e marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Unë nuk dua, që deputetët e këtij Kuvendi të paragjykojnë që mund të ndodhë një krizë. Ne mund të parashohim shumë gjëra që mund të ndodhë, ndoshta ndonjëherë ndonjë krizë, mirëpo duhet të kemi edhe besimin e plotë që krizat financiare nuk është lehtë të ndodhin dhe nuk do të ndodhin kriza financiare kur do të vijë, të krijohet mundësia që të bëhen reduktime.

Këtu nuk thuhet, që do të ndërpritet krejt, por në raste specifike, të jashtëzakonshme, të cilat vështirë që mund të ndodhin, atëherë parashihet kjo dhe është pjesë e marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Prandaj, zoti nënkryetar, unë kërkoj nga të gjithë deputetët që në këto momente, kur jemi në prag të nënshkrimit të marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar, të mos rrezikojmë, sepse nuk është ashtu siç po paragjykohet këtu se mund të bëhet një diskriminim ndaj kësaj, ndaj Forcës së Sigurisë apo dikujt tjetër.

Megjithatë, kjo çështje është e paraparë edhe në ligjet tjera.

KRYESUESI: Po e marrë si mundësi edhe Liburnin, që ta marrë fjalën një a dy minuta.

LIBURN ALIU: Në rast krizash, po shpresojmë që nuk do të ketë kriza, duhet ta kemi të qartë, se është e kuptueshme që duhet të ketë shkurtime buxhetore dhe kursime, por duhet ta dimë që këto kursime në kurriz të kujt bëhen. Deri tani ky nen neve na ka ardhur tek skemat sociale, tek pensionistët, që ishte në plan të vinte, që u kthye ligji, ka ardhur tek veteranët e luftës dhe tani tek pensionistët e FSK-së.

Pra, kemi të bëjmë me kategoritë sociale. Ta dimë ne të qartë, komplet pasqyrën se kujt krejt kanë për t'iu ndalur të hollat, kujt kanë për t'iu bërë shkurtimet buxhetore, në rast krizash dhe atëherë do të mund të kemi një qëndrim. Por, kështu veç e veç, për secilën kategori veç e veç, është e papranueshme, them kjo është... natyrisht shpresojmë që të mos ketë ndonjë krizë njëherë të vazhdojmë kështu me këtë mirëqenie qysh jemi duke jetuar, veç të ecim përpara.

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Unë, qysh në lexim të parë ia kam tërhequr vërejtjen edhe ministrit të resorit përkatës edhe ministrit për Punë dhe Mirëqenie Sociale, por nuk kanë pasur përgjigje, a është ky pension i rregullt apo pension suplementar? Tash i ka vërejtur, pasi ka kaluar leximin e parë, këtë e ka vërejtur edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, por kjo bie komplet në kundërshtim me natyrën e këtij ligji dhe vetë kategorinë e cila dëshiron ta rregullojë me anë të pensionimit.

Prandaj, Komisioni funksional mirë ka bërë që nuk e ka përkrahur këtë, me keqardhje, sepse nuk rrezikohet buxheti në këtë formë dhe nuk mbrohet në këtë formë. Duhet në fillim, kur të vijë ligji dhe kur të hartohet legjislacioni, jo për dëshirë dhe vullnet të individëve, por për hir të interesave shtetërore.

Prandaj kjo është e vonuar, e cila komplet e devalvon edhe vetë natyrën e këtij projektligji.

Dhe e dyta, kush mundet neve si deputetë ose edhe atyre pjesëtarëve të FSK-ës ... që t'ua heq frikën, që të mos mund të përdoret nga Qeveria, që çdoherë mund të ketë tendencë, sot ua bëj pensionin, nesër nuk ua bëj pensionin dhe kjo ia lejon.

Prandaj, ky amendament nuk duhet të votohet dhe është shumë parimore, që Komisioni funksional nuk i ka dhënë përkrahje këtij amendamenti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka zoti Selimi

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!
Meqë kryetari i Komisionit nuk është këtu edhe një herë po dua ta konfirmoj, që ky amendament është pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Pra, Komisioni Funksional i ka rekomanduar Kuvendit, që të mos e votojë këtë amendament dhe si të tillë ne mendojmë që nuk mund të mbrohet buxheti i Kosovës, duke i reduktuar pensionet e ushtarakëve.

Pra, edhe njëherë e rikonfirmoj në emër të Komisionit, që ky amendament nuk e ka përkrahjen e Komisionit funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Zoti Xhelili e ka fjalën, i fundit.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!
Përshëndetje për Kabinetin Qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Është e vërtetë që Komisioni funksional ka marrë qëndrim, që mos ta përkrahë këtë amendament dhe të gjitha ato që i thanë parafolësit, qëndrojnë në rrjedhën logjike të menduarit të ligjet dhe të aprovimi i një ligji të tillë. Mirëpo, sipas shpjegimeve sot edhe të ministrit të Financave, po edhe kryetares të Komisionit për Buxhet dhe Financa, duke marrë parasysh se ky është një prej kritereve të Fondit Monetar Ndërkombëtar për nënshkrimin e marrëveshjes, atëherë për të mos e rrezikuar ligjin në tërësi, që të bien si ligj, ne si Grup Parlamentar të Partisë Demokratike, do ta përkrahim këtë amendament edhe i lus deputetët tjerë, që të përkrahim, në mënyrë që mos ta rrezikojmë ligjin, se gjithë ato që u thanë më parë prej parafolësve, qëndrojnë.

KRYESUESI: Faleminderit!
Tjerë të paraqitur nuk ka.
E votojmë me elektronikë, amendamentin 11. Do të thotë, ky amendament edhe njëherë po e përsëris unë, është i Komisionit për Buxhet dhe Financa, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Në sallë janë 81 deputetë. Votojmë tani. Faleminderit!

Konstatohet që amendamenti 11, nuk miratohet.
41 vota janë “kundër”, 4 abstenime, 31 vota janë “për”.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Votojmë tani.
Faleminderit!

Konstatohet që me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për pensione të pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës, që është

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbime të shoqërisë informatike

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për shërbime të shoqërisë informatike dhe Kuvendi i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamente të propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, nuk është këtu. E do dikush, në emër të komisionit fjalën? Nuk e ka kërkuar askush. A s’është ky projektligj... në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 44 amendamente, nga Komisioni funksional.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit funksional.

Amendamenti 1.

Kundër, s’ka.

Abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër, s’ka.

Abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër, s’ka.

Abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër, s’ka.

Abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër, s’ka.

Abstenim, s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 11.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 12.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet!

Amendamenti 13.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 14.

Kundër, s'ka.

Abstenim, s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 15.
Kundër, s'ka.
Abstenim, s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 16.
Kundër, s'ka.
Abstenim, s'ka.
Miratohet!

Amendamenti 17.
Kundër, s'ka.
Abstenim, s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 18.
Kundër, s'ka.
Abstenim, s'ka.
Miratohet!

Amendamenti 19.
Kundër, s'ka.
Abstenim, s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 20.
Kundër, s'ka.
Abstenim, s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 21.
Kundër, s'ka.
Abstenim, s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 22.
Kundër, s'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 23.
Kundër, nuk ka,
Abstenim, nuk ka,
Miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.
Kundër, nuk ka,
Abstenim, nuk ka,
Miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25.
Kundër, nuk ka,
Abstenim, nuk ka.
Miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26.
Kundër, nuk ka,
Abstenim, nuk ka.
Miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27.
Kundër, nuk ka,
Abstenim, nuk ka.
Miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28.
Kundër, nuk ka,
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 29.
Kundër, nuk ka,
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 30.
Kundër, nuk ka,
Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Amendamenti 31.
Kundër, nuk ka,
Abstenim, nuk ka,
Miratohet.

Amendamenti 32.
Kundër, nuk ka,
Abstenim, nuk ka,
Miratohet.

Amendamenti 33.

Kundër, nuk ka,
Abstenim, nuk ka,
Miratohet.

Amendamenti 34.
Kundër, nuk ka,
Abstenim, nuk ka,
Miratohet.

Amendamenti 35.
Kundër, nuk ka,
Abstenim, nuk ka,
Miratohet.

Amendamenti 36.
Kundër, nuk ka,
Abstenim, nuk ka,
Miratohet.

Amendamenti 37.
Kundër, nuk ka,
Abstenim, nuk ka,
Miratohet.

Amendamenti 38.
Kundër, nuk ka,
Abstenim, nuk ka,
Miratohet.

Amendamenti 39.
Kundër, nuk ka,
Abstenim, nuk ka,
Miratohet.

Amendamenti 40.
Kundër, nuk ka,
Abstenim, nuk ka,
Miratohet.

Amendamenti 41.
Kundër, nuk ka,
Abstenim, nuk ka,
Miratohet

Amendamenti 42 dhe i fundit
Kundër, nuk ka,

Abstenim, nuk ka.
Miratohet.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara, Votojmë tani. Në sallë janë 75 deputetë. Faleminderit!

Konstatoj se me 72 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për shërbimet e shoqërisë informatike.

Pika e tetë siç e dini është shtyrë.
Tani, vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës, që është

9. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me propozim- vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Paraprakisht ministri Besim Beqaj e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: I nderuar , nënkryetar,
Të nderuar deputetë,
Përfaqësues të Qeverisë,
Unë kisha kërkuar në bazë të Rregullores së Kuvendit për shkak të dilemave të cilat janë ngritur në grup punues, këtë pikë të rendit të ditës ta shtyjme për javën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Konstatoj që Qeveria si propozues ka të drejtë të kërkojë që ta tërheqë propozimin. Atëherë e hedh në votim formal, a jeni që ta shtyjme? Ka të drejtë, nuk di për cilat dilema, zoti Beqaj, a mund ta arsyetoni pak më shumë se hapët debat.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Sigurisht, zoti nënkryetar,
Shpjegimi është se në Komisionin funksional ka pasur debate, nuk ka pasur pajtime të plota, prandaj ne kërkojmë që brenda një jave të arrijmë një harmonizim edhe më të fuqishëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Në bazë të Rregullores së Kuvendit, Qeveria ka të drejtë të kërkojë tërheqjen edhe të ligjit edhe të vendimeve.
Zoti Beqiri, e ka kërkuar fjalën në emër të Grupit Parlamentar.
Zoti Beqiri e keni fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!
Me të vërtetë së pari kjo pikë është futur në rend të ditës, e dyta duhet të na tregoni pse po tërhiqet, a po i tërheqin kandidatët që i kanë propozuar, apo po e bën këtë vetëm për arsyen e thjeshtë që s’ka pasur debat. Qysh s’ka pasur debat kur është vendimi i Komisionit funksional për të mos e përkrahur, kjo nuk qëndron. Prandaj, ne këto lojëra

po i shohim, është shumë e qartë që kjo duhet të qitet në votim, dhe jo kësisoj ta lëshojnë tash qysh po e lëshojnë një nga një që është problem tjetër ky.

Të lus, këtu nuk ka arsytim sepse Qeveria po e tërheq, arsytimi se s'është bërë debat i mjaftueshëm nuk qëndron, mund të jetë që s'i përshtatet që s'ka kaluar në Komision, kjo është tjetër çështje. Por, opinioni duhet ta dijë, Komisioni funksional nuk i ka përkrahur, gjegjësisht s'e ka përkrahur vendimin e Qeverisë për këta anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit. Prandaj, sipas procedurës kjo nuk mund të dalë kësisoj prej rendit të ditës, po duhet të votohet.

Propozimi i LDK-së do të ishte edhe është që ky propozim t'i kthehet mbrapshtë Qeverisë, si i papranueshëm dhe të sjellë emra tjerë. Faleminderit!

KRYESUESI: Po unë dua t'i referohem Rregullores, nenit 56.5 që shkruan: "Propozuesi mund të tërheq projektligjin gjatë shqyrtimit në Kuvend deri para fillimit të votimit në shqyrtimin e dytë". Mirë, mirë, unë dakord, e kam të qartë që është projektligj, po është propozim, njësoj është si propozimin e vet, si projektligjin, Qeveria ka të drejtë ta tërheqë. Prandaj....

(Reagim)

Unë nuk kam zgjidhje tjetër me Rregullore, në këtë rast nuk shkruan askund për shqyrtimin e Raportit për zhvillim ekonomik, por është një propozim siç është ligji është edhe ky propozim i Qeverisë. Të drejtën ta tërheq Qeveria e ka se kjo është propozues, jo kur s'më pëlqen mua, këtë të drejtë Rregullorja po ia jep. Ismet Beqiri, edhe një herë e ka fjalën në emër të Grupit.

ISMET BEQIRI: Zoti nënkryetar,

Unë ju lus edhe nëse kërkon diçka çfarë kërkoi Qeveria, ky Kuvend duhet të deklarohet, por para kësaj duhet të deklarohet edhe çfarë po kërkojnë, ose po e thonë siç ishte kërkesa e imja në emër të Grupit Parlamentar, që mund të kenë kërkesa nuk e di çfarë grupet tjera, që duhet t'i thonë qëndrimet e veta. Prandaj, ne do të ballafaqohemi me dy, atë që e kërkon zoti ministër tërheqjen, pa justifikim ose shtyrjen, dhe ne që kërkojmë që kjo të futet në rend të ditës në kuptimin, është në rend të ditës, po të shtyhet, gjegjësisht t'i kthehet Qeverisë si e papranueshme si propozim, si vendim, ne këtë e kërkojmë.

Prandaj, është e drejtë e jona që të kërkojmë që ky vendim i Qeverisë të refuzohet dhe t'i kthehet mbrapshtë dhe të ndërrohet propozimi i Qeverisë, këto janë tash, dalin dy propozime.

KRYESUESI: Zoti Beqiri, të njëjtën gjë mund ta bëjmë edhe javën tjetër, në qoftë se vjen.

Radhën e ka përfaqësuesi i "Vetëvendosjes", zoti Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne këtu, Qeveria e ka dërguar një listë prej tre emrash për t' i emëruar, për t' i votuar si anëtarë të bordit edhe kryesues të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë. Disa prej këtyre emrave, jo të gjithë, disa prej këtyre emrave, as nuk e kanë përvojën e mjaftueshme profesionale, e as përvojën e punës, madje- madje disa aty edhe janë konflikt i drejtpërdrejt interesi për t' u emëruar këtu. Edhe tash kjo kërkesë e Qeverisë mua po ma shton dyshimin edhe më shumë me shty për një javë çka për të harmonizuar çështje që t' i mbyllim sytë para kësaj shkelje, edhe të procedurave, edhe të profesionalizmit kërkuar për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë. Prandaj, ne jemi kundër që të shtyhet për një javë, se për një javë nuk mund të ndryshojë kjo në Komision është votuar edhe Komisioni ka dalë kundër këtij propozimi të Qeverisë, pastaj ky propozim i është dërguar seancës që të vendosë. Pra, të votojmë për propozimin e Qeverisë edhe le të votojë kush “për” e kush “kundër”. Mirëpo, ky është realiteti që e kemi, shtyrja një javë nuk e ndryshon këtë, përveç nëse mendohet që gjatë kësaj shtyrje një javë të ndryshohet përbërja e Komisionit apo të ushtrohet trysni e ndryshme ndaj tyre.

KRYESUESI: Faleminderit!

A t' ia japi edhe Gjinit fjalën, e kanë kërkuar fjalën edhe Muhamet Mustafa, e pastaj e merre edhe një herë ti.

Zoti Gjini, e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Mendoj se po vijmë në lajthitje për çështje të cilat nuk duhen me qenë temë e debatit në Kuvend. Ky votim është votim përfundimtar, që do të thotë është sikur votimi i një projektligji në lexim të dytë. Nuk është më i Qeverisë, është i Komisionit. Letrën që e kemi marrë ne, ka ardhur prej Komisionit, jo prej Qeverisë edhe ne duhet të votojmë, edhe për ta shënuar këtë ditë dua me ju thanë që Kuvendi i Kosovës ndoshta është ndër Kuvendet e rralla, mos me thënë i vetmi në botë ku Qeveria prishë kuorumin. Deputetët e PDK-së e kanë lëshuar sallën se e kanë parë që nuk kanë vota, edhe kërkesa e Qeverisë për ta tërhequr është se si ka votat se e panë në votim më përpara, për mos me ju kthye mbrapsht propozimi. Është e pandershme prej anës së Qeverisë kjo, duhet t' i disiplinojë deputetët e vetë me i pas në sallë ose mos me sjell demokracinë e Kosovës në këso situata kaq qesharake, ku keni parë bre që Qeveria prish kuorumin, ku keni parë që deputetët e partive në pushtet e lëshojnë sallën, veç te na.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Muhamet Mustafa e ka fjalën, në emër të Koalicionit Kosova e Re.

MUHAMET MUSTAFA: Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, kërkojmë që propozimi i Qeverisë të refuzohet dhe t' i kthehet Qeverisë që të vijë me një propozim më të mirë. Unë mendoj se duhet të rishqyrtohet përbërja e atij rregullatori sepse aty tash, përpos gjërave që u cekën këtu edhe struktura profesionale e Rregullatorit, aty janë gati 70 – 80% inxhinierë të makinerisë, nuk ka ekonomistë, nuk juristë. Kështu që për të funksionuar mirë Rregullatori duhet Qeveria t' i rishqyrtojë edhe një herë dhe të na bie kandidatë më të mirë. Prandaj, me të vërtetë tash jem në lexim të dytë për tërheqjen nga rendi i dytë, ka hyrë në rend të dite, ka propozuar komisioni

përkatës me kthye, dhe unë mendoj se ne sot duhet ta përkrahim propozimin e Komisionit.

KRYETARI: Faleminderit!

Zoti Beqaj, a e dëshironi fjalën?

MINISTRI BESIM BEQAJ: Zoti nënkryetar,

Në bazë të Rregullores së Kuvendit, sponsorizuesi ka të drejtë për ta tërhequr, prandaj, kërkesa jonë është për çështje teknike të shtyhet për një javë kjo pikë e rendit të ditës.

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Zemaj, që s'ka diskutua hiq për këtë çështje. Zoti Gjini, replikë ka, në rregull, me fal Zemaj.

ARDIAN GJINI: Unë po i replikoj ministrit, për shkak se iu referua fjalës sime. Nuk ka të drejtë sponsoruesi, se nuk është sponsorues më. Sponsoruesi i kësaj që kemi në tavolinë është Komisioni, jo Qeveria edhe mos të na kallëzojë Rregulloren këtu.

KRYESUESI: Deputeti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Zoti nënkryetar,

Ju e dini fortë mirë edhe e dinë mirë edhe ministri, që kjo çka po thotë është kundërshtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

E para, propozuesi mund ta tërheqë edhe para leximit të dytë, por ky tash nuk është propozues, është Komisioni funksional i vendimit që e ka prua të Komisionit. Dhe, para leximit të dytë vetëm ai mund, Komisioni mund të propozojë që ta tërheqë dhe ka të drejtë, po nëse tërhiqet, do të thotë, që duhet të bien ndryshime. Prandaj, kërkesa për shtyrje është diçka tjetër, ndërsa për tërheqje është diçka tjetër. Nëse ministri pajtohet t' i tërheqë në emër të Qeverisë, ata emra edhe ne pajtohemi që Komisioni është pajtuar që ata nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret, dhe kjo është arsyeja edhe formale edhe juridike.

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Mendoj se këtu po bëhet një luftë e panevojshme dhe e paarsyeshme.

E para, ministri nuk ka të drejtë të komentojë dhe ta interpretoj Rregulloren këtu. Për mendimin tim interpretues autentik i Rregullores gjatë seancës jeni ju si kryesues i seancës dhe interpretues mund të jenë të gjithë deputetët tjerë, anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe jo ministri, i cili është përfaqësues i ekzekutivit. Nuk mundet të na tregoj ai se çka bëjmë ne, nuk mundet të na tregoj se qysh e bëjmë ne dhe nuk mundet të na tregoj se çfarë vendimesh marrim ne. Propozimi i tij ka ardhur, nuk ka kaluar në Komision, Komisioni propozimin e tij e ka quajtur propozim të paarsyeshëm, jo profesional dhe nuk ka kaluar në Komision. Prandaj, këtu vendos seanca, vendos Kuvendi dhe jo ministri. Propozimi i ministrit është i palogjikshëm sot në seancë që të shtyhet për një javë. Ka qenë i palogjikshëm dhe i paarsyeshëm edhe jo profesional kur iu

ka dërguar Komisionit i cili e ka rrëzuar atë vendim, sot Kuvendi i thotë që nuk ka as arsye, as bazë juridike, as mbështetje në Rregulloren e Punës së Kuvendit, që të propozojë ta shtyjë për një javë, është e paarsyeshme kjo punë. Të kthehen nëse i tërheq emrat në Qeveri, për ta bërë një korrektim ose ku di unë çka duhet bërë atje, është diçka tjetër, mundeni të gjejnë njëfarë kompromisi, po të propozojmë për ta shtyrë për një javë kjo është e paarsyeshme. Pse ta shtyjmë për një javë, çka kemi të bëjmë ne për një javë e nuk kanë kaluar në Komision, çka kem për të bërë ne me këta emra, s'kanë kaluar në Komision, ne këta deputetë jem, ata njerëz që janë propozuar të njëjtin janë, nuk do të kalojnë as në seancë, as në Komision, kështu që vendosim ne, nëse ministri nuk i tërheq vetë, ne ja kthejmë si seancë edhe kryhet kjo punë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Zonja Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Zoti kryesuesi,
Unë jam nënkryetare e këtij Komisioni edhe kam qenë aty kur është diskutuar edhe ku është votua për këtë pikë të rendit të ditës.

Qeveria i ka sjell dhe Qeveria nuk ka më të drejtë as ta shtyjë as t'i ndryshojë, Qeveria mundet me i prua ata emra pa të drejtë që t' i ndryshojë sa është në Kuvend apo në Komision, edhe qysh tha ministri që nuk jam e sigurt edhe atë që mundet, por e vetmja mundësi është t'i tërheqë, por ajo tërheqje do të thotë me i marrë me veti e me i qua prapë aty prej nga kanë ardhur. Po nuk ka të drejtë ministri ta caktojë agjendën e Kuvendit, shtyrje, ndryshime e të tjera. Arsyeja pse janë refuzuar në Komision, ka qenë arsyeja profesionale, arsyeja të cilën ata nuk e plotësojnë. Do të thotë që anëtarët e propozuar kanë qenë me profesion inxhinierë të makinerisë, ndërsa jemi duke folur për një Zyre të Rregullatorit të Energjisë ku kemi të bëjmë me energjetikë. Edhe te anëtarët tjerë ka pasur arsye profesionale të cilat kanë shkaktuar votimin kundër.

Prandaj, Komisioni nuk mendoj që ka arsye që të ndryshojë mendimin e vet edhe nuk ka të drejtë Kuvendi që ta kthejë në Komision për ndryshim, Komisioni e ka dhënë fjalën.

Në anën tjetër Qeveria le të ketë kujdes kenë e propozon e mos të na vjen këtu të na tregoj çka duhet bërë, a duhet ta shtyjmë një javë a nuk duhet ta shtyjmë a duhet ndryshuar? Në qoftë se e merr le ta marrë me veti edhe le ta qon prej atje nga kanë ardhur.

KRYESUESI: Nuk ka të tjerë të paraqitur. Sidoqoftë unë jam i detyruar edhe një herë ta lexoj pikën 5 të nenit 56. "Propozuesi mund ta tërheqë projektligjin gjatë shqyrtimit në Kuvend deri para fillimit të votimit në shqyrtimin e dytë".

Unë po dua të konstatoj tash diçka tjetër. Ne nuk mund ta hedhim në votim as atë çështje, as këtë çështje, sepse kuorum nuk ka. Në Parlament janë 50 deputetë dhe e lëmë këtë për seancën e ardhshme.

(Reagime – polemikë- nuk dëgjohet)

Po, propozo zoti Hamiti. Propozo çka të bëj me 50 deputetë, unë këtu, dhe me këtë propozimin këtu.

(Ndërhyrje e S. Hamitit: Nuk dëgjohej.

KRYESUESI: T'i e di që as s'jam me prish Kuvendin as s'kam qenë kurrë. Hajt, qysh po thua ti?

KRYESUESI: A po e merr fjalën zyrtarisht, a qysh po do?
Pra, ta ndezi mikrofonin.

Zoti Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: ... Zotni, me Rregullore nuk ke të drejtë të bësh çka po bën ti. Kaq. Nëse për dy emra që me kryeneçësi një ministër donë me i qua në një Rregullator, me kryeneçësi të paarsyeshme, doni ta prishni Kuvendin, urdhëroni. Unë mendoj që nuk ia vlen, s'di kush janë ata, as pse janë, të bëhen bravura të tilla me kryeneçësi të paarsyeshme, totalisht. Këtë e them edhe tash, edhe sot, edhe nesër edhe gjithë. Nuk ka nevojë, kjo me prish kuorumin qysh po priset këtu për arsye, sepse duhet të shtyhen kandidaturat me çdo kusht edhe kur një komision thotë jo, kjo është me prishë Kuvendin. Kaq. S'kam tjetër.

KRYESUESI: Unë mendoj që as unë as ju s'jeni dakord me prishë Kuvendin dhe askush këtu s'është dakord.

(Ndërhyrje)

Jo, jo, nuk jam dakord se nuk kam dhënë prova të tilla, asnjëherë. Prandaj, unë duhet t'i referohem Rregullores që e kemi miratuar bashkë dhe e keni votuar edhe ju. Ne me Rregullore punojmë. Konstatoj që ne s'kemi kuorum për të votuar dhe seanca ka përfunduar.

Mirupafshim në seancën e ardhshme!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim e Lekturë